



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRAN

01 Nr. / Br 251/23
Nr. i fq. / Br. st - 1 -
Data: / Datum 17. 11. 2023
VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28.1 të Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **30 nëntor 2023 (e enjte) me fillim në ora 11:00.**

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 tetor 2023;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. "Përparimi" SH.A për vitin 2022;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për caktimin e normave tatimore të pronave;
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale;
6. Shqyrtimi i Informatës për menaxhimin e mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;
8. Pyetje dhe përgjigje;

Melihate Basholli-Latifi


Kryesuese e Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 250/23


Nr. i fq. / Br. st - 2 -

Data: / Datum 17.11.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



KOMUNA VUSHTRRI
OPËSTINA VUÇITRN

PËR:	Kuvendin e komunës
NGA:	Melihate Basholli Latifi  Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
TEMA:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 16.11.2023

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **16 nëntor 2023** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Raportit i Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. "Përparimi" SH.A për vitin 2022.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi që të përgatitet lista e të punësuarve që nga themelimi i N.P.L. "Përparimi" SH.A e deri në nëntor 2023 dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim. U kërkua që paraprakisht të bisedohet me Zyrën Ligjore se a është shkelje e të drejtave të njeriut dhe konfidenciale publikimi i kësaj liste.
2. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e normave tatimore të pronave.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi që në këtë formë të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim. Kurse, Kryetari i Komunës, Kryesuesja e Kuvendit dhe drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa do të mbajnë një takim konsultativ me shefat e grupeve kuvendare para mbledhjes së kuvendit.
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të bashkengjitet lista e pronave që janë në shfrytëzim (lokacioni dhe sipërfaqja), atyre që kanë qenë në shfrytëzim (lokacioni dhe sipërfaqja) dhe u ka skaduar kontrata, shuma e qirasë, borxhet ndaj komunës dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

5. Shqyrtimi i Informatës për menaxhimin e mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë.
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.
***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të bashkengjitet lista e bizneseve të shuara dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -IX- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 26 TETOR 2023

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:15. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Mehulli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 35 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës. *Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.*

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-njoftoj se anëtari i kuvendit Lorik Maaxhuni, është emërua në pozitën e Drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë njëjti ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të kuvendit, në vendi të tij nga KQZ është zëvendësuar z. Jeton Gjaka të cilin e ftoj ta jap betimin.

Jeton Gjaka para kuvendit dha betimin, duke u bërë anëtar i kuvendit me të drejta të plota.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –tha se është për keqardhje dështimi i mbledhjes së muajit korrik për disa herë me radhë, dhe për këtë e kupton deri diku opozitën, por nuk mund ta kuptoj pushtetin, i cili po ik dhe nuk e di askush dhe për çfarë është duke ikur nga çfarë ka frik. Kjo me fjalë tjera i bie se pozita apo pushteti është dorëzuar nga votuesit apo e ka braktisur besimin qytetar. Në krejt këtë çështje nga pushteti po fshihet se ka njerëz të tyre që janë të përfshirë në shkelje ligjore dhe kjo konstatohet me një aneks kontratë e cila është me datën 20 dhjetor 2020 ndërsa me datën 23 të po të njëjtit muaj të viti 2020 përfundon projekti dhe kjo kontratë ka vlerën mbi 33,000.00 €, andaj shtrohet pyetja si ka mundur që ky projekt të përfundoj për më pak se një javë. Prandaj dihet fakti se kush ka qenë drejtor në atë kohë, kush ka qenë projekt-menaxher i kontratës dhe kush e ka bërë pranimin teknik të projekti-ndërtimi i objekti të QKMF-së në Vushtrri. Në fund lidhur me këtë çështje kërkoj të merret organet e hetuesisë dhe të prokurorisë.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –kërkoj nga DKA në Vushtrri që të mirëmbahet busti apo përmendorja e heroit Lutfi Musiqi, i cili ndodhet në oborrin e shkollës së mesme profesionale

Bahri Haxha, dhe në të njëjtën kohë duhet të bëhet zhvendosja e këtij busti nga oborri i shkollës, pasi që dihet se nga viti 2005 është bërë ndarja fizike e shkollës teknike në Vushtrri, në shkollën teknike dhe shkollën profesionale, ndërsa busti ka mbetur në oborrin e shkollës profesionale “Bahri Haxha”. Prandaj vendosja e bustit të heroit kombëtar aty ku e ka vendin në oborrin e shkollës teknik e cila edhe e mbanë emrin e tij, është detyrim për komunën dhe DKA-në Vushtrri, por edhe nderë për heroin dhe familjen e tij. Më tej ngrit shqetësimin e tij për siç tha të nxënësve të SH.M.T.”Lutfi Musiqi” ku siç është e ditur në hyrje e oborrit të kësaj shkolle ndodhet një transformator i energjisë elektrike i cili paraqet rrezik për nxënësit, kërkoj që komuna në bashkëpunim me KEDSI të bëj dislokimin e atij transformatori në një vend tjetër më të përshtatshëm. Mandej përsërit shqetësimin e largimit të tre autobusëve të prishur në oborrin e SH.M.T.”Lutfi Musiqi” në Vushtrri të cilët i japin një pamje të shëmtuar oborrit të kësaj shkolle.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit –propozoi që shtëpia e Kahriman Pasomës në cilën në vitin 1999 janë ekzekutuar në mënyrë barbare nga forcat barbare serbe 68 shqiptar të shndërrohet në shtëpi apo muze të gjenocidit në formë zyrtare nga Komuna e Vushtrrisë ashtu që mbetet në kujtesën kolektive për gjenerata e ardhshme, si shenjë e terrorit dhe gjenocidit të ushtruar nga aparati serb në Kosovë.

Behar Duraku, anëtar i kuvendit-ngritit shqetësimin e tij sepse edhe pse ka kaluar data 15 tetor akoma nuk ka filluar shpërndarjen e lëndëve djegëse për ngrohej nëpër shkolla, dhe po ashtu shprehu shqetësimin për parregullsi në procesin e shpërndarjes së këtyre lëndëve nëpër shkolla. Lidhur me këtë çështje kërkoj të ngritët një komision i cili do të përcjell punën dhe procesin e furnizimit të shkollave me lëndë djegëse.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-përcjelli shqetësimin e bizneseve të vogla-kiosqeve që shtrihen në shesh i cili është duke u rinovuar, e të cilëve iu është lëshuar një urdhëresë nga komuna për lirimin e atyre kiosqeve për shkak të punimeve në shesh, për këtë kërkoj nga Drejtoresha e Urbanizimi që të sqaroj se ku do të vendosen ato kiosqe me qëllim që të mos dëmtohen ato biznese sepse siç dihet këto biznese i mbajnë familjet e tyre me këto veprimtari.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarë e kuvendit, njoftoj se në kuadër të buxhetit për vitin 2024 është paraparë rregullimi dhe dislokimi i bustit të heroit “Lutfi Musiqi”. Lidhur me çështjen e autobusëve që ndodhen në oborrin e shkollës njoftoj se për këtë çështje është formuar një komision dhe mendohet që përmes ankandit të bëhet shtija dhe zhvendosja e atyre autobusëve nga atje. Lidhur me dislokimin e transformatorit nga oborri i shkollës “Lutfi Musiqi” njoftoj se kjo çështje bie në kompetencë të KEDS-it, por u zotua se në bashkëpunim me këta të fundit të punohet për ta gjetur një zgjidhje. Pastaj lidhur me shtëpinë e Kahriman Pasomës, njoftoj se për këtë çështje është biseduar mes kryetarit të komunës dhe Ministrisë së Kulturës, për futjen e kësaj shtëpie në listën e monumenteve historike, ndërsa kryetari i komunës është zotuar se në bashkëpunim me kuvendin do të iniciojë procedurën për shpronësimin e kësaj shtëpie dhe të shpallet si monument historik i Komunës së Vushtrrisë apo muze i gjenocidit. Sa i përket bizneseve apo kisosqeve në shesh të qytetit do të shikohet mundësia që të gjendet një vend sa më i përshtatshëm për ta ushtruar veprimtarin e tyre deri në përfundimin e punimeve në shesh.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –tha se bazuar në udhëzimin administrativ në fuqi komision për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave propozohet nga Drejtoria e Arsimit, ndërsa ky propozim është ardhur nga kryetari i komunës në kundërshtim me udhëzimin administrativë, në këtë rast ose duhet të hiqet nga rendi i ditës kjo pikë ose duhet të korrigjohet ky propozim-vendim.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –propozoi që të futet në rendin e ditës propozim-vendim për ofrimin e mbështetjes financiare për shërim për ish asamblistin e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë z.Fitim Halili, i cili është dignostifikuar se vuan nga një sëmundje e rënd.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –në emër të grupit kuvendar të LVV-së kërkoj nga kuvendi që të hiqet nga rendi i ditës pika e 8 (tetë) Propozim – vendimi për ndarjen e mjeteve financiare ndërmarrjes publike lokale “Përparimi” SH.A në Vushtri, për faktin se e njëjta nuk ka kaluar në shqyrtim në Komitetin për Politikë dhe Financa, dhe kjo për faktin se çdo pikë që është e natyrës financiare, duhet të shqyrtohet fillimisht nga KPF-ja, kësaj ku ja shtojmë edhe faktin se kjo ndërmarrje përmes Komisionit të Aksionarëve akoma nuk ka sjellë raport për gjendjen në këtë ndërmarrje. Prandaj në mbledhjen e radhës duhet të silllet ky propozim bashkërisht me raportin për të parë se si janë shpenzuar mjetet e ndara më herët për këtë ndërmarrje, duke iu bashkangjitur edhe lista e të punësuarve në këtë ndërmarrje.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –tha se në bazë të rekomandimeve të dal nga mbledhja shohim se propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare ndërmarrjes publike lokale “Përparimi” SH.A në Vushtri, është shqyrtuar nga Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe i njëjti është proceduar për kuvend.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se aprovimi i propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare ndërmarrjes publike lokale “Përparimi” SH.A në Vushtri, është në interes të përgjithshëm sepse kemi të bëjmë me pavarësimin e kësaj ndërmerrej sa i përket menaxhimit të mbeturinave si dhe në pajisjen e kësaj ndërmarrje me makineri të nevojshme për kryerjen e këtyre shërbimeve andaj kjo shumë e propozuar mendojmë që është simbolike. Kërkojë që kjo pikë të aprovohet me unanimitet të plotë të kuvendit.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit –tha se ideja që hiqet nga rendi i ditës propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare ndërmarrjes publike lokale “Përparimi” SH.A në Vushtri, nuk është e qëlluar për faktin se raporti i ndërmarrjes nuk është i lidhur me propozim-vendimin për subvencionimin e kësaj ndërmarrje. Lidhur me raportimin e komisionit të aksionarëve të kësaj ndërmarrje vlerësoi se ky komision i ka shkelur obligimet ligjore lidhur me raportimin dhe tani raportimi është i pa efektshëm, andaj në rastin konkret duhet të kërkohet votëbesimi i këtij komisioni në kuvend duke ia marr mandatin të njëjtit apo duhet shkarkuar thënë në mënyrë lakonike, sepse ky komision nuk i ka përmbushur detyrat dhe obligimet që i ka në bazë të ligjit dhe për të cilat e ka autorizuar kuvendi i komunës.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-vlerësoi se askush nuk është që të stopohet puna e ndërmarrjes “Përparimi” dhe shtoj se në kërkesën për mjetet për subvencionimin e saj është dashur të bashkëngjitet edhe dokumentacioni shtesë që ministria e linjës ia ka lejuar kësaj kompanie zgjerimin e veprimtarisë së saj për menaxhimin e mbeturinave, kërkoj që kjo pikë të përkraket.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-njoftoi se i gjithë dokumentacioni për zgjerimin e veprimtarisë së ndërmarrjes “Përparimi” është përfunduar konfrom ndryshimeve ligjore që janë bërë dhe nëse është e nevojshme atëherë i njëjti mund të dërgohet përmes adresës elektronik tek anëtarët e kuvendit.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –tha asnjë nga kriteret e parapara në udhëzim administrativ nuk janë respektuar, sepse bazuar në normativë decidivisht thuhet se anëtarët e komisionit duhet të kenë eksperiencë nga fusha e arsimit dhe të jenë ekspert të pavarur nga po e njëjta fushë ndërsa anëtarë e propozuar nuk i përmbushin këto kritere atëherë në bazë të kësaj del se nuk është respektuar kuadri ligjor që buron nga udhëzimi administrativë për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në komuna nga fusha e arsimit. Më tej shtoj se kjo nguti e formimit të këtij komisioni po bëhet edhe për faktin se pushteti dëshiron që shpejtëshpejt të bëjnë zyrtarizmin e

disa drejtorëve sidomos nëpër çerdhe ku ka pasur shkelje ligjore në rekrutimin e tyre sidomos në çerdhen nr.3 ku është zgjedhur drejtoresha me përgatitej me shkollë të mesme dhe në këtë rast është shkelur ligji në mënyrë flagrante.

Në vazhdim kuvendi pika e propozuar në të ndryshime i votoj në mënyrë të veçantë dhe atë si në vijim:

Me vota “unanime” kuvend vendosi që futet në rendin e ditës për shqyrtim Propozim–vendimi për plotësimin e vendimit lidhur me themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Me 17 vota “për” 1 votë kundër kuvend vendosi që futet në rendin e ditës për shqyrtim Propozim–vendimi për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë.

Me vota “unanime” kuvend vendosi që futet në rendin e ditës për shqyrtim Propozim–vendimi për ofrimin e mbështetjes financiare për shërim për z.Fitim Halili.

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për” 5 vota “kundër” të tjerat “abstenim” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 26 shtator 2023;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 28 shtator 2023;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit nëntëmujor të shpenzimeve për periudhën janar – shtator 2023;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për hartimin e Draft – Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024 – 2032;
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm në Komunën e Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore të punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për vitin 2023;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ndarje të mjeteve financiare ndërmarrjes publike lokale “Përparimi” SH.A në Vushtri;
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për plotësimin e vendimit lidhur me themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë;
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ofrimin e mbështetjes financiare për shërim për z.Fitim Halili;
12. Pyetje dhe përgjigje.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 26 shtator 2023;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 shtator 2023.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 28 shtator 2023;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 shtator 2023.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit nëntëmujor të shpenzimeve për periudhën janar – shtator 2023;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –vlerësoi se raporti në mënyrë decidive tregon për dështimin e qeverisë Idrizi në shpenzimin e buxhetit për vitin 2023 e në këtë rast në mënyrë të veçantë shpërfaq dështimin në realizimin e investimeve kapitale në Komunën e Vushtrrisë për vitin buxhetor 2023. Në këtë kontekst duke iu adresuar qytetarëve shtoj se përpara kemi raportin nëntë mujor të shpenzimeve janar-shtator 2023 nga Komuna e Vushtrrisë, raport ky që fatkeqësisht për vitin e dytë me radhë tregon dështimin e Qeverisjes Idrizi për të realizuar buxheti në mënyrë të suksesshme e me këtë dështon realizimin e investimeve kapitale të parapara në këtë vit buxhetor. Të dashur qytetarë Qeverisja Idrizi në gjashtë mujorin e parë kishte rekord të zi si rrallë ndonjë komunë në Kosovë, duke realizuar buxhetin për investime kapitale në vetëm 1%. Tash 3 muaj pas ky realizim buxhetor ka arritur shkallën vetëm 16 %, që tregon për dështimin total të kësaj qeverisje. Nga 8, 590, 396 euro sa janë planifikuar për investime kapitale deri me 30 shtator janë realizuar vetëm 1, 411. 364 euro investime duke mbetur të pa realizuara afro 7 milion euro. Për më keq as kategoria e subvencioneve që tradicionalisht është realizuar në nivel të kënaqshëm në nëntë mujorin e parë nuk ka kaluar 50% të realizimit ajo është ndalur në vetëm 48%. Le ti ndajmë për publikun disa nga të dhënat sipas drejtorive përkatëse lidhur me tabelën e investimeve kapitale për janar-shtator 2023:

1. Drejtoria e Administratës të planifikuara 97.000 euro të realizuara 0 euro të realizuara. Kjo nuk do koment më tepër.
2. Drejtoria e Bujqësisë nga 853. 576 euro ka realizuar vetëm 22, 719 euro investime apo 2.66%. Kjo është performancë skandaloze.
3. Drejtoria për Urbanizëm nga 3, 018. 046 euro ka realizuar vetëm 442.28 euro investime kapitale apo 14.65%, në ndër kohë kanë mbetur mbi 2.5 milion euro që rrezikohen për të shkuar në suficit vetëm në këtë drejtori.
4. Drejtoria për Shëndetësi nga 651.690 euro të planifikuara për investime kapitale ka realizuar për 9 muaj vetëm 109,641 euro apo 16.82% dhe shumica e projekteve të planifikuara figurojnë me zero duke përfshirë komplet kodin për shërbime sociale dhe rezidenciale.

5. Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport nga 248,568 euro sa ka planifikuar për investime kapitale ka realizuar 0 (zero) euro investime duke qenë e dyta nga drejtorit që nuk ka arritur as një cent investime kapitale për nëntë muaj.
6. Shumë me rëndësi për ta cekur megjithëse nevoja për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit është më se fundamentale për lokalitetet që nuk kanë rrjet dhe me gjithë planifikimin për investim në shumën prej mbi 500. 000 euro për shtrirje të rrjetit në lokalitetet si Pasomë, Beqiq, Duboc, Stanoc, Dumnicë, Mihaliq e Prelluzhë as edhe një cent investime nuk është bërë në këta nëntë muaj në ndër kohë qeverisja Idrizi ka shpenzuar mbi 60 mije euro për dreka dhe udhëtime zyrtare.

Në kategoritë tjera që vlen të cekem

- Janë rritur shpenzimet në raport me vitin paraprak për këshillëdhënës nga 36 Euro në 39. 493 euro.
 - Janë rritur shpenzimet në raport me vitin paraprak për shpenzime kontraktuese për afro 1 milion euro nga 1, 261.641 në 2,044. 282 euro.
 - Janë rritur shpenzimet në procedurat e blerjeve më pak se 1000 euro nga 23.998 në 38. 956 euro.
 - Janë rritur shpenzimet për përfaqësim e avokaturë nga 6.458 euro në 15.204 euro.
 - Janë rritur shpenzimet avancë për udhëtime zyrtare nga 902 euro në 32,493 euro.
 - Janë rritur shpenzimet për drekat zyrtare nga 23,079 euro në 31,377 euro.
- Gjërat qesharake:
- Në drejtorin për Buxhet dhe Financa është planifikuar asfaltimi i rrugës Pantinë-Ashlan në vlerën prej 332 euro!
 - Në të njëjtën drejtori është planifikuar riparimi i shkollës Krasniqe e Poshtme në vlerën 1 euro.
 - Në Drejtorin e Shërbimeve Publike është planifikuar fondi për bashkëfinancim në vlerën 2 euro dhe rregullimi i sheshit Hasan Prishtina në vlerë prej 37 euro.
 - Në Drejtorin e Bujqësisë është planifikuar ngritja e serave në vlerë prej 2 euro, kurse ngritja e pemishteve në vlerë prej 991 euro.

Me gjitha këto të dhëna ky raport është mallkimi që po përjeton Komuna e Vushtrrisë nga kjo qeverisje.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi me 12 vota “për” 11 vota “kundër” aprovoj Raportin nëntëmujor të shpenzimeve për periudhën janar – shtator 2023.

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për hartimin e Draft – Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024;

Pas propozimeve nga anëtarët e kuvendit, pas votimit me vota “unanime” u vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet komisioni për hartimin e Draft-planit të punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024, në përbërjen si në vijim:

- 1.1 .Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit;**
- 1.2 Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit (PDK);**
- 1.3 Shkelzen Xhaferi, anëtar i kuvendit (LDK);**
- 1.4 Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit (LVV);**
- 1.5 Mensur Kastrati, anëtar i kuvendit (AAK);**

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, duhet të takohet brenda një afati të arsyeshëm dhe të hartojë draftin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024, dhe të njëjtin duhet t'ia propozojë Kuvendit të komunës për aprovim në mbledhjen e muajit dhjetor 2023.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024 – 2032;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 27 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim inicohet procedura e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) për Komunën e Vushtrrisë në afat të vlefshmërisë 2024-2032.

2. Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i Planifikimit Hapësinor-Plani Zhvillimor Komunal në harmoni me ligjin si: “Plan Strategjik multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor, Plani Zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare”

3. Me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, nga neni 1 i këtij Vendimi planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësit për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të Komunës së Vushtrrisë me qëllim të mbulimit të tërë territorit të Komunës së Vushtrrisë, duke përgatitur Planin Strategjik multi sektorial , i cili përfshin planifikimin dhe zhvillimin e Zonës Urbane dhe Rurale.

4. Ky plan mbulon tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë dhe bazuar në PZHK-në e aprovuar me vendim Nr. 126/17 të datës 04.05.201 Vushtria ka territor prej 345 km², ose 34,500.00ha.

5. Bartës i hartimit të planit Zhvillimor Komunal caktohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë tjera të cilat funksionojnë brenda Komunës.

6. Mjetet për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë.

7. Projekti i PZHK-së para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe shqyrtim publik, paraqitja e PZHK-së në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallet përmes njoftimeve publike.

8. Dokumenti i planifikimit hapësinor hartohet për periudhën kohore 8 vjeçare.

9. Deri në Miratimit e Planit Zhvillimor Komunal vlejné dispozitat e Planit Zhvillimor Komunal, aktual me Nr. 126/17 të datës 04.05.2017, deri në miratimin e këtij akti të ri.

10. Dokumenti i planifikimit (PZHK) sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhë zyrtare të Komunës dhe së paku 3 Kopje të shtypura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

11. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm në Komunën e Vushtrrisë;

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –tha se ky raport parqet gjendjen me ujë të pijshëm nga aspektet e ndryshme si: prodhimi, distribuimi, faturimi, inkasimi dhe shpenzimet, nga tabela shihet se për tre mujorin e parë të vitit 2023 kemi prodhim të ujit në sasi-vëllim prej 6,81.617 m³. Të shpërndara nëpër komuna rezulton se në Komunën e Mitrovicës kemi 2,46.522 m³ ujë, Komuna e Vushtrrisë 1,640.645 m³ ujë dhe Skenderaj me 576,200.00 m³ ujë. Gjatë periudhës së parë të këtij viti shihet se janë faturuar 3,000.000 m³ ujë, kurse të pa faturuara evidentohen 3,440.762 m³ apo shprehur në përqindje i bie që 53% e ujit të prodhuar është i pa faturuar, pra kemi një rritje të mos faturimit të ujit krahasuar me vitin 2022 në vlerë prej 12 %. Tek inkasimi gjatë periudhës së parë të këtij vite shihet se kemi inksim në vlerë prej 8,340.269 €, ku kemi një rritje prej 7%. Sa i përket shpenzimeve shihet së është shqetësuese që gjatë tre mujorit të parë të vitit 2023 kemi shpenzime prej 9,34000.510 €, ndërsa inksimi është 834,269.00 €, apo shihet se kemi inksim më të dobët në krahasim me shpenzimet në vlerë mbi 100.000€. Në Komunën e Vushtrrisë në periudhën janar-mars 2023 kemi pasur vetëm 103 konsumator të rinj dhe kjo është shqetësuese sepse dihet se kemi një numër të madh të ekonomive familjare që nuk janë të kyqyra në rrjetin e ujësjellësit dhe kjo tregon që gjendja e furnizimit me ujë të pijes në Komunën e Vushtrrisë nuk është e kënaqshme, andaj inkurajojmë komunën që në bashkëpunim me kompaninë të bëjnë përpjekje për përmasimin e kësaj gjendje.

7. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore të punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për vitin 2023;

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit – Pyeti se a ka shënime lidhur me një ngjarje që ka ndodhur në vitin 1991 në fshatin Stanofc i Epërm, kush janë pirësit dhe organizatorët e asaj ngjarje, ku për rrjedhojë në këtë rast kanë rënë dy dëshmorët e kombit, andaj lidhur me këtë ngjarje a ka ndonjë shënim zyrtar që e mbanë drejtoria e komunës .

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit – pyeti lidhur me kontratën për renovimin e fushës së sportit “Musa Abazi”, si dhe renovimin e zhveshtorës të stadiumit “Fërki Aliu”.

Kjo kontratë është e lidhur me vitin 2021, kërkoj nga DKRS të sqaroj se kur do të fillojnë punimet në këto dy projekte nga ana e operatorit ekonomik dhe a janë ndërmarr masa ligjore ndaj këtij operatori, për mos kryerjen e punëve të cilat janë dashur të përfundojnë në vitin 2021. Kërkesa për rregullimin e nxemjës në palestrën e sporteve “Afrim Bunjaku” në fshatin Samadrexh. Pse nuk është realizuar kjo kërkesë dhe cilat janë arsyetimet pse nuk është filluar me rregullimin e kësaj nxemje. A është realizuar pagesa në vlerë prej 800 euro për shkollën e tenisit si dhe a ka paraparë drejtorja e kulturës mjete financiare për ndërtimin e fushës së tenisit. Lidhur me më një operator ekonomik i cili për vite me radhë është treguar i papërngjeshëm kërkoj që ndaj ti të ndërmerren masa, por pikërisht në këtë qeverisje ka ndodhur e kundërta sepse edhe pse nuk i ka kryer punën si duhet prapëseprapë i njëjti ka fituar tender nga Komuna e Vushtrrisë. Këtij operatori duhet shqiptuar masa që mos të ketë të drejt të konkurroj në tenderët e ardhëm në Komunën e Vushtrrisë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - pyeti DKRS se a janë subvencionuar shoqëritë kulturo-artistike nga ana e drejtorisë në komunën e Vushtrrisë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit - pyeti se çfarë është duke ndodhur me projektet kapitale në drejtorin e kulturës që kanë qenë të planifikuara në buxhetin e komunës, a janë iniciuar dhe zhvilluar procedurat e prokurimit, nëse po në çfarë faze gjenden, nëse nuk janë iniciuar këto procedura atëherë kush është duke i bllokuar këto projekte dhe cili është interesi i drejtorisë tuja për bllokimin e këtyre projekteve? Nëse nuk janë iniciuar këto procedura të prokurimit, atëherë i bie që drejtorja fare nuk është interesuar fare për realizimin e këtyre projekteve, sepse shpenzimi i buxhetit për projektet kapitale në këtë drejtori është në vlerën zero.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit –fillimisht vlerësoi se puna e punëtorëve në DKRS është për tu përshëndetur, sepse ata janë tepër të angazhuar dhe punojnë edhe pas orarit të punës e shpesh edhe gjatë vikendeve, por për keqardhje është angazhimi i eprorëve në këtë drejtori që nuk punojnë dhe nuk krijojnë kushte as për punëtor e lere më në shpenzimin e buxhetit për investime kapitale. Jeni në muajin e dhjetë të vitet dhe asnjë projekt nuk është duke u zhvilluar në këtë drejtori, dhe tani në fund të vitit nuk do të mund të shpenzohet buxheti pasi që mbyllen kodet buxhetore, krejt kjo është pasoj e mos vizionit të udhëheqës së kësaj drejtorie.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit -pyet DKR-në- lidhur me subvencionimin e OJQ-ve si dhe për pronarët e tyre, sepse ka informacione që disa nga përfituesit e OJQ-ve, janë persona që janë të lidhur me persona të afërt me pushtetin, p.sh. të dihen pronarët e OJQ-ve si në vijim: ISKAN e cila ka informacione se është pronare vajza e kryetarit të AAK-së në Vushtrri, IRDS, pronar i kësaj OJQ-je është Donat Zabergja, djali i asamblisti Bekim Zabergja. Në fund kërkoj të sillen emrat e pronarëve të OJQ-ve që janë subvencionuar nga DKRS-ja në Vushtrri.

Medina Bunjaku, drejtoreshë e DKRS-së-paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me çështjet e ngritura nga anëtarë e kuvendit.

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ndarje të mjeteve financiare ndërmarrjes publike lokale “Përparimi” SH.A në Vushtrri;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –tha se kjo çështje do ishte konsideruar si urgjente nëse këto mjete do të dedikoheshin për pagat e punëtorëve të Kompanisë “Përparimi”, por këto mjetet në vlerë prej 60,000 € po ndahen për blerjen e majtëve të punës të cilat nuk kanë natyrë urgjente, por e rëndësishme është fakti se me këtë shumë të mjeteve nuk mund të blihen mjete makineri kualitative sepse kamionët dhe kompktorët për mbeturina janë shumë të kushtueshme dhe me këto mjete nuk do të bëhej ndonjë zgjidhje e mirë sepse kjo shumë nuk është e mjaftueshme. Për më tepër ajo që është akoma më keq është se këto mjete po merren nga kategoria subvencione dhe po

shpërndahen në investime kapitale në Përparim, që është shkelje ligjore sepse nga subvencionet nuk mund të financohen projekte kapitale. Në fund shtoj se ata si grup politikë nuk kanë asgjë kundër që të ndihmohet kjo ndërmarrje por gjithëherë duhet të respektohet ligji, sepse për më tepër nuk ka kaluar koj pikë në KPF dhe fillimisht duhet të sjellët në kuvend raporti i Komisioni të Aksionarëve.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se lidhur me ofrimin e raportit për gjendjen dhe raportin e auditorit për NPL. “Përparimin”, pajtohet me parafolësin se këto raport duhet të dërgohen në kuvend nga kjo e fundit, po lidhur me përkrahjen financiare të kësaj ndërmarrje duhet të gjithë të jemi unik sepse e njëjta duhet përkrahur sepse ka nevojë. Më tej shtoj se duhet shmangur politikat populiste lidhur me kompaninë në fjalë sepse duhet mbështet kjo kompani për tu pavarësuar në ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave.

Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit-tha se nuk ka kurrfarë lidhje raporti i komisionit të aksionarëve të kësaj ndërmarrje me propozimin për subvencionimin e ndërmarrjes. Esenca e kësaj çështje është se kemi të bëjmë me subvencion që po ndahet nga komuna për blerjen e mjeteve themelore të punës për këtë ndërmarrje, dhe kjo dallon nga format tjera të donacioneve, sepse destinimi i këtyre mjeteve është vetëm për mjete të punës dhe nuk mund të përdoren për qëllime tjera nga ndërmarrja. Ai përgëzoi menaxhmentin e kompanisë që ka konsoliduar dokumentacionin për zgjerimin e aktivitetit operativ të kompanisë dhe kërko që në mënyrë unanime të votohet ndarja e këtyre mjeteve për këtë kompani.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit –tha se kemi dështime nga të gjitha anët dhe dështimi kryesor është në shpenzimin e buxhetit në kapitale, mandej shtoj se kërkesa e kompanisë “Përparim” është që të iu ndahen 295.000.00€ me destinim për mjete të punës, ndërsa vlera prej 60,000.00€ është tejet e pamjaftueshme për ta mbuluar koston e mjeteve themelore. Në fund tha se nuk ka kuptim që asnjëherë kjo ndërmarrje nuk ka sjellë raport në kuvend për gjendjen e saj dhe për punësimet familjare që janë bërë këto dy vite.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –përsërit se është dashur që këtij propozim ti bashkëngjitet edhe dokumentacioni përkatës sa i përket zgjerimit të veprimtarisë së kësaj ndërmarrje, ndërsa kërkesa për mbështetje financiare është tepër valide dhe shumë e nevojshme që të plotësohet nga ana e kuvendit. Kjo është e rëndësishme sepse do ta bënte të qëndrueshme këtë kompani në gjenerimin e mjeteve vetnake.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-tha se drejtorja ka bërë një analizë financiare nga fondi i subvencioneve, ku në vitin 2023 shuma prej 60,000.00 € të merren nga Drejtorja për Emergjencë dhe Drejtorja për Arsim, në rastin konkret konstatoj se kjo ndarje nuk karakterizohet me keq klasifikim dhe shkelje ligjore sepse po bëhet fjalë për ofrimin e ndihmës për këtë ndërmarrje. Subvencionet lejohen të ndahen me vendim të kuvendit dhe nuk kemi kurrfarë shkelje ligjore.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 18 vota “për” 8 vota “kundër” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, ndahen mjete financiare nga buxheti i komunës – subvencione dhe transfere të vitit 2023, në shumë të përgjithshme prej 60,000.00 € (gjashtëdhjetëmijë euro) për N.P.L “Përparimi” SH.A. në Vushtri (mbështetje financiare) për blerje të mjeteve të punës – Kamion për bartje të mbeturinave (Kompaktor), kontejnerë etj.

2. Mjetet në shumën e cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen si vijon:

2.1. Nga buxheti i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, 40,000.00 € (katër dhjetë mijë euro), kodi ekonomik (18468) menaxhimi i fatkeqësive natyrore , subvencione dhe transfere;

2.2. Nga buxheti i Drejtorisë për Arsim kodi ekonomik (92120), 20,000.00 € (njëzetmijë euro), subvencione dhe transfere.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtoria për Arsim.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për plotësimin e vendimit lidhur me themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –kërkoj të respektohet rregullorja për themelimin e komiteteve të kuvendit në komuna, që të bëhet përfaqësimi i të gjitha entiteteve politike të përfaqura në kuvend, sepse kjo edhe në të kaluarën nuk është respektuar apo është shkelur.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit –vlerësoi se çelësi i themelimit të Komitetit për Politikë dhe Financa nuk është respektuar atëherë kur është bërë themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –duke ju referua parafolësit të tij, kërkojë që ai të bëhet zëdhënës i LVV-së, e mos të merre me anëtarë e LDK-së, sepse ai nuk dihet se cilit subjekt politik i takon.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –tha se çdo propozim që bëhet në kuvend sa i përket zgjedhjes si anëtarë i KPF-së, duhet të qitet në votim dhe ai që merr vota më shumë ai duhet të zgjidhet, kjo për fatin se përfaqësimi në komitet bëhet sipas asaj se gjykim bëhet mbi bazën e vendeve në kuvend jo sipas përfaqësimit partiak siç edhe është vepruar edhe më herët.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –adresoj kritika tek kryesuesja e kuvendit e cila sipas tij nuk është duke i udhëhequr si duhet mbledhjet e kuvendit, kjo për faktin se është e obliguar që ti qetë në votim të gjitha kërkesat e parashtruar nga anëtarë e kuvendit. Kjo po ndodh rëndom tek kryesuesja sepse ajo është e varur nga ekzekutivi komunal dhe merr urdhra nga këtë të fundit, gjë e cila nuk është dashur ti pranoj dhe të ndodhë një gjë e tillë. Më tej shtoj se normat dhe rregullt janë të qarta dhe vlejë për tërë territorin e Republikës së Kosovës, prandaj në rastin konkret AAK-në kuvend ka dy anëtarë dhe i takon të ketë përfaqësuesin e vetë në gjirin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-tha se sa i përket themelimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, ligji është mjaft i qartë, sepse ligji nuk njehë grupe kuvendare por njehë subjekt politike që kanë fituar në zgjedhje e që përfaqësohen në kuvend, dhe në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të viti 2021 AAK-ja ka vetëm 1 anëtar të kuvend, ndërsa kalimi i deputetit të LB-së në AAK është vetëm formal. Lidhur me deklaratimet e anëtarit të AAK-së në kuvend, kërkoj sqarim deri në seancën e radhës lidhur me përfaqësimin e tyre në kuvendin e komunës dhe koalicionin qeverisës.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesja e kuvendit i hodhi në votim dy propozime për anëtar të KPF dhe atë për anëtarin e kuvendit Mentor Hasani i cili mori 18 vota “për” si dhe anëtar i kuvendit Mensur Kastrati i cili mori 13 vota “për”, andaj nga ky rezultat u vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i kuvendit me numër të protokollit 01.Nr.04/22 i datës 14.01.2022 lidhur me themelimin e Komiteti për Politikë dhe Financa ashtu që në vend të z.Lorik Maxhuni nga radhët e PDK-së emërohet z.Mentor Hasani nga i njëjti subjekt politikë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë;

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –tha se në këtë propozim-vendim kemi shkelej ligjore për faktin se drejtori i arsimit ka dhënë dorëheqje ndërsa në vendim figuron emri i tij dhe ndëshkim i tij.

Melihate Basholli, Latifi- Kryesuese e Kuvendi-tha se ky propozim-vendim është hartuar në kohën kur drejtor ka qenë z.Dardan Abazi, ndërsa nënshkrimi i tij nuk figuron por është nënshkrimi i ndonjë zyrtari të autorizuar nga DKA-ja.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit –tha se gjendja në arsimin e Komunës së Vushtrrisë është katandisur krejtësisht, sepse për më pak se dy vite janë ndërruar tre drejtor të arsimit, ndërsa në fushatën zgjedhore kryefjala e kryetari aktual të komunës ka qenë arsimit dhe avancimin i tij, por tani jemi para degradimit total të kësaj fushe vitale për Komunën e Vushtrrisë. Kryetari i komunës është marrë vetëm me dy gjëra në arsim me punësime të militantëve partiak pa kritere dhe më tender të renovimeve të shkollave pa kurrfarë kriteri dhe standardi. Lidhur me propozimin për zgjedhjen e komisionit për drejtorët e shkollave, ceku se janë propozuar persona që nuk janë kredibil e të cilët janë edhe politikisht të anëshëm dhe nuk mund të jetë pjesë e këtij komision, për këtë ftojë të gjithë anëtarët e kuvendit që të votojnë kundër këtij propozim-vendimi.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –përsërit se ky komision i propozuar nuk është adekuat dhe nuk është në pajtim me udhëzimin administrativ, sepse anëtarët e këtij komisioni duhet të kenë të paktën përgatitjen profesionale ekuivalentë me kandidatet për drejtor apo zëvendësdrejtor në një institucion arsimor, dhe kjo nuk është respektuar në rastin konkret. Mandej procedimi i kësaj pike të rendit të ditës është bërë me vonesë, sepse komisionit të më hershëm i ka kaluar mandati në muajin korrik të këtij viti. Tutje shtoi se në këtë komision përpos që janë propozuar emra të cilët nuk janë profesionist të fushës së arsimit, janë njerëz që janë të dëgjueshëm politikisht ndaj partisë në pushtet dhe krejtësisht po bëhet me qëllime të qarta për punësime të njerëzve të afërt të partisë në pushtet.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se propozimi për këtë komision është ardhur në formën e rregullt ligjore, ndërsa i njëjti është propozuar nga DKA-ja që është në kompetencën e saj, dhe tani ne si kuvend nuk mund ta kontestojmë profesionalizimin e këtij komisioni paraprakisht. Më tej shtoi se nuk është mirë të mërimi dhe duhet të jemi të kujdesshëm, kur përmendim emra të

përveçshëm sepse duhet të mos etiketohen zyrtaret komunale. Votimi i këtij komisioni në kuvend është më tepër i karakterit formal dhe nuk duhet të shkaktohen pengesa në këtë proces por duhet të votohet unanimitisht ky propozim-vendim.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 15 vota “për”, 13 vota “kundër” vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet Komisioni për përpërgjedhje për vendet e punës, drejtor dhe zëvendës drejtor, në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta në Komunën e Vushtrrisë, me këtë përbërje:
 - 1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe personel i DKA-së
 - 1.2. Visar Sadriu, drejtor i SHFMU”Andon Zako Çajupi”Vushtrri
 - 1.3. _____, përfaqësues i MASHT-it.
2. Komisioni do t’i zhvillojë të gjitha procedurat për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar.
3. Komisioni i cekur si në pikën 1 të këtij vendimi ka mandat për një vit shkollor.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Arsimit dhe komisioni i lartcekur.
5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ofrimin e mbështetjes financiare për shërim për z.Fitim Halili;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se propozimi është i natyrës urgjente, për shkak se z.Fitim Halili është diagnostifikuar se vuan nga një sëmundje e rëndë kancerogjene, i njëjti ka nevojë emergjente që ta trajtoj këtë sëmundje. Propozoj që ti ndahen mjete financiare në vlerë prej 7000 euro nga kategoria subvencione dhe transfere në buxhetin e komunës, ndërsa për zbatimin e këtij vendimi të obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim z. Fitim Halili, i ofrohet mbështetje financiare në shumë prej shtatë mijë euro (7000.00 €) për nevoja të shërimit i cili vuan nga një sëmundje e rëndë kronike.
2. Mjetet financiare të cekur në pikën paraprake të këtij vendim do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe në drejtoritë tjera komunale aty ka mjete të lira nga po e njëjta kategori buxhetore.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtorit tjera kompetente komunale.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

13. Pyetje dhe përgjigje:

Behar Duraku, anëtar i kuvendit-pyeti drejtorin e Bujqësisë, lidhur me mos realizimin e pagesave, për shumën prej 5 cent për litër të qumështi në formë subvencioni për fermerët e Komunës së Vushtrrisë.

Ergyn Sunguri, drejtor i DEBPZHR-së- dha sqarimet lidhur me çështjen e ngritur nga anëtari i kuvendit z.Behar Duraku.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-pyeti se deri ku kanë shkuar procedurat lidhur me ndërtimin e urës në lagjen e Kastratëve, e cila ishte dëmtuar gjatë vërshimeve të verës së këtij viti.

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-u përgjigj në pyetjen e parashtruar nga anëtari i kuvendit z.Ali Januzi.

Mbledhja përfundoi në ora: 14:45.

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës


Kryesuese e Kuvendi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUÇITRN

DATE:	07.11.2023
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
NGA:	Komisioni Komunal i Aksionarëve Kryesuesi i Komisionit, Qemajl Hasani 
LËNDA:	Raport i Komisionit Komunal të Aksionarëve për vitin 2022

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur Raportin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për vitin 2022

Me respekt!



KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE I N.P.L "PËRPARIMI" SH. A NË VUSHTRRI

**RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KOMISIONIT KOMUNAL TË
AKSIONARËVE**

Qemal Hasani

Kryesues i Komisionit

Vushtri, 2023

Përmbajtja

Hyrje	3
1. EMËRIMI DHE PUNA E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE.....	3
1.1 VLERËSIMI I PUNËS SË BORDIT TË DREJTORËVE DHE KOMISIONIT TË AUDITIMIT	4
1.2 EMËRIMI I BORDIT TË PËRKOHSHËM TË DREJTORËVE	6
1.3 CAKTIMI I KOMPENSIMIT PËR ANËTARËT E BORDIT TË DREJTORËVE.....	7
1.4 MIRATIMI I STATUTIT TË N.P.L “PËRPARIMI” SH. A	7
1.5 AKTET E BRENDSHME TË NDËRMARRJES.....	9
2. NUMRI I TË PUNËSUARVE NË FUND TË MUAJIT DHJETOR.....	10
3. MARRËVESHJET E NDËRMARRJES ME KOMUNËN E VUSHTRRISË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNALE	10
3.1 PASTRIMI I OBJEKTEVE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE.....	10
3.2 SIGURIMI FIZIK	11
4.SHERBIMET E MIRËMBAJTJES SE HAPËSIRAVE PUBLIKE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË	
11	
5.SHPENZIMET E NDËRMARRJES GJATË VITI 2022	19
6.LETRA E MENAXHMENTIT DHE OPINIONI I AUDITIMIT TË JASHTËM.....	24
7.PËRFUNDIMI	24

Hyrje

Ky raport është hartuar nga Komisioni Komunal i Aksionarëve në përputhshmëri me nenin 8.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike në të cilin thuhet si në vijim: “8.2 Çdo Komision Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me këtë ligj. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë të përcaktuar në nenin 6.2 të këtij 6 ligji.. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të NP-së përkatëse Lokale në interes të Komunës ose Komunave përkatëse.”

Në këtë raport janë bërë sqarimet lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Komisioni në bazë të Ligjit për Ndërmarrje Publike, dhe në të njëjtën kohë është bërë një sqarim në lidhje me numrin e të punësuarve të ndërmarrjes në fund të vitit kalendarik 2022, po ashtu në kuadër të këtij raporti kemi përfshirë pasqyrat vjetore të ndërmarrjes për vitin kalendarik 2022¹, ku i kemi bashkëngjitur letrën e menaxhmentit dhe opinionin e auditorit të jashtëm në lidhje me vërtetësinë e Pasqyrave Vjetore Financiare.

Qëllimi:

Të paraqes në mënyrë objektive se në çmasë janë realizuar objektivat e Komisionit Komunal të Aksionarëve, dhe në të njëjtën kohë të vlerësohet performanca e ndërmarrjes për vitin kalendarik 2022.

Objektivat:

- Vlerësimi i performancës së Bordit të Drejtorëve;
- Vlerësimi i punës së Komisionit të Auditimit;
- Caktimi i kompensimit për Bordin e Drejtorëve në pajtueshmëri me Ligjin për Ndërmarrjet Publike;
- Vlerësimi i punës së ndërmarrjes në përgjithësi;
- Miratimi i Statutit të N.P.L “Përparimi” Sh. A;

1. EMËRIMI DHE PUNA E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE

¹ Sqarim: Të dhënat që gjenden në Kapitujtë 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 janë dërguar nga ana e ndërmarrjes.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me datë 31.01.2022, kishte marr vendimin me të cilin kishte zgjedhur/emëruar dy (2) anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L “Përparimi” Sh. A. Këtë vendim e kishin bazuar në nenin 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të cilin po e citoj si në vijim: “5.2 Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal.”.

Me datë 03.02.2023, Kryetari i Komunës duke zbatuar nenin e mësipërm ku kishte emëruar një anëtar nga Ekzekutivi i Komunës si Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve, të cilit edhe i besohet nga anëtarët e Komisionit, roli i Kryesuesit të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Neve gjatë kësaj periudhe kemi zbatuar dhe jemi duke zbatuar Ligjet si në vijim: Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111, Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

Nga data 27.12.2022, është zëvendësuar Kryesuesi i Komisionit Komunal të Aksionarëve me një anëtar tjetër nga ekzekutivi.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihni punën e Komisionit Komunal të Aksionarëve:

Tabela Nr. 1: Puna e Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Nr.	Lloji i aktivitetit	Viti 2022
1.	Mbledhje të rregullta të mbajtura nga Komisioni Komunal i Aksionarëve	5
2.	Procesverbale të miratuara nga Komisioni Komunal i Aksionarëve	5
3.	Vendime nga Komisioni Komunal i Aksionarëve	9
4.	Vlerësim i Performancës së Bordit të Drejtorëve	1
5.	Emërim i Bordit të Përkohshëm	1
6.	Statuti i Miratuar	1

1.1 VLERËSIMI I PUNËS SË BORDIT TË DREJTORËVE DHE KOMISIONIT TË AUDITIMIT

Si komision komunal i Aksionarëve me rastin e marrjes së detyrës, kemi pritur nga Bordi i Drejtorëve i mëparshëm se do të dorëzonte një raport në lidhje me punën e tyre një (1)

vjeçare që përfshinë propozimet dhe planifikimet e tyre në lidhje me punën e ndërmarrjes, e sidomos të njoftohemi në lidhje me punën dhe rolin e Komisionit të Auditimit.

Bordi i Drejtorëve me datë 06.04.2022, nëpërmes Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve na kanë përcjell raportin vjetor të punës së N.P.L “Përparimi” Sh. A për vitin 2021, ku në kuadër të emalit të dërguar është cekur se Bordi i Drejtorëve me datë 01.04.2022 ka miratuar Raportin Vjetor të punës së N.P.L “Përparimi” Sh. A.

Bordi i Drejtorëve me datë 03.06.2022 nëpërmes Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve na kanë përcjell raportin tre (3) mujor për periudhën janar – mars të N.P.L “Përparimi” Sh. A për të cilin na njoftojnë se është miratuar, dhe në formë të informatës të njëjtin po na e përcjellin neve.

Tek komisioni i auditimit me datë 26.05.2022 është parashtruar kërkesa që të na dorëzohen të gjitha ftesat dhe procesverbalet e të gjitha takimeve zyrtare, dhe është kërkuar nga ana e tyre raporti i auditimit të pasqyrave financiare të N.P.L “Përparimi” Sh. A. për vitin kalendarik 2021.

Nga Komisioni i Auditimit kemi pranuar një raport i cili ka pas vetëm një (1) faqe në të cilën thuhet se nga data 21.12.2021, kur kanë pranuar vendimin kanë mbajtur vetëm një mbledhje dhe atë me datë 18.03.2022, në të cilin i kanë propozuar bordit të drejtorëve që të bëhet miratimi i raportit vjetor. Po ashtu në kuadër të raportit ceket se kanë rekomanduar të shqyrtohet mundësia e sigurimit të programit për kontabilitet, dhe të shqyrtohet mundësia e plotësimit vendit të lirë për pozitën e punës “Auditor i Brendshëm”.

Pra neve duhet të jemi të qartë se ky Komision ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 pika h) të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ku thuhet se Komisioni i Auditimit: *“do të emërojë, shkarkojë dhe zëvendësojë Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm si dhe të përcaktojë kompensimin dhe përfitimet e tij/saj, përcaktim ky që duhet të pasqyrohet në deklaratën e politikës së kompensimit të kërkuar sipas Nenit 20.4.”*, e jo bordi i drejtorëve, pra kjo çështje është kompetencë ekskluzive e Komisionit të Auditimit. Komisioni i Auditimit i është përgjigjur në mënyrë të pjesshme kërkesës së Komisionit Komunal të Aksionarëve, duke mos dorëzuar dokumentet e kërkuara, përveç raportit të cekur më lartë.

Bordi i Drejtorëve nuk ka realizuar asnjë komunikim me Komisionin Komunal të Aksionarëve, duke mos e njoftuar Komisionin në lidhje me Planin e Biznesit të Ndërmarrjes për vitin kalendarik 2022, po ashtu nga të gjeturat vërehet se Bordi i Drejtorëve ka pranuar kompensim financiar pa vendim të Komisionit Komunal të Aksionarëve, njëjloj ka vepruar edhe Komisioni i Auditimit duke pranuar kompensim financiar pa vendim të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Prandaj, Komisioni Komunal i Aksionarëve me datë 28.06.2022 ka marr vendimin me të cilën bëhet shkarkimi i Bordi të Drejtorëve për arsyet si në vijim:

1. Mos dërgimi i Planit të Biznesit Komisionit Komunal të Aksionarëve;

2. Mungesa e kryerjes së vlerësimit të përgjithshëm të përmbushjes së detyrave të bordit së paku një herë në vit;
3. Mungesa e strategjive dhe plane gjithëpërfshirëse të punës së ndërmarrjes nga ana e Bordit të Drejtorëve;

1.2 EMËRIMI I BORDIT TË PËRKOHSHËM TË DREJTORËVE

Komisioni Komunal i Aksionarëve me qëllim që të ruhet stabiliteti i ndërmarrjes, me datë 14.07.2022, ka vendosur që të bëjë emërimin e Bordit të Përkohshëm dhe atë duke u bazuar në Nenin 22 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të cilin po e citoj si në vijim: Neni 43 i ligjit bazik, paragrafi 43.1. riformulohet si në vijim: *“43.1. Qeveria është e autorizuar që ta emërojë një Bord të Përkohshëm të Drejtorëve (“Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve”) për secilën NP për të shërbyer në cilësinë e Bordit të Drejtorëve të NP-së për një periudhë gjashtëmujore, duke filluar me miratimin e Vendimit mbi Themelimin e një Ndërmarrje Publike të re apo nga shkarkimi i bordit aktual deri në përzgjedhjen e bordit të përhershëm në përputhje me nenin 15 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.”*

Bordi i Përkohshëm ishte emëruar për një periudhë gjashtë (6) mujore, ku ishin emëruar katër (4) anëtarë të Bordit të Drejtorëve, ndërsa anëtari i pestë (5) i Bordit të Drejtorëve është Kryeshefi Ekzekutiv sipas detyrës zyrtare.

Me datë 20.07.2022 ishte thirr mbledhje konstituive nga ana e Kryesuesit të Komisionit Komunal të Aksionarëve, ku mbledhja ishte mbajtur në selinë e N.P.L “Përparimi” Sh. A, ku ishte zgjedhur Kryesuesi i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve. Mbledhja ishte udhëhequr nga Kryesuesi i Komisionit Komunal të Aksionarëve deri në zgjedhjen e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve pas zgjedhjes, mbledhja kishte vazhduar të udhëhiqet nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve.

Aktiviteti i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve për vitin kalendarik 2022 pas marrjes së detyrës është prezantuar me anë të tabelës së poshtme:

Tabela Nr. 2: Puna e Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve.

Nr.	Lloji i aktivitetit	Viti 2022
1.	Mbledhje të rregullta të mbajtura nga Bordi i Drejtorëve	6
2.	Procesverbale të miratuara nga Bordi i Drejtorëve	6
3.	Vendime nga Bordi i Drejtorëve	15
4.	Plotësim Ndryshime të Rregulloreve të miratuara	1
5.	Raporte tre (3) mujore	2
6.	Plan i biznesit	1

Për shkak se një anëtar i Bordit të Drejtorëve, në mënyrë të vazhdueshme kishte munguar nga mbledhjet e bordit ishte marr vendimi që i njëjti të zëvendësohet, ashtu që nga data 24.08.2022 ishte emëruar një anëtare e re e Bordit të Përkohshëm. Arsyeja e zëvendësimit qëndron duke u bazuar në nenin 12 par. 4 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të cilin po e citoj si në vijim: “4. Një drejtor është i detyruar që t’i kushtojë kohë të mjaftueshme ushtrimit të rregullt të detyrave të tij si drejtor, duke përfshirë kohën e pjesëmarrjes dhe përgatitjes për mbledhjet e Bordit.”

1.3 CAKTIMI I KOMPENSIMIT PËR ANËTARËT E BORDIT TË DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve ka të drejtë në kompensim në bazë të nenit 20.1 Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ku thuhet se: “20.1 Drejtorëve do t’u paguhet një honorar themelor, i cili përcaktohet në përputhje me Nenin 20.2, për kohën e shpenzuar në mbledhjet e Bordit. Drejtorëve po ashtu do t’u paguhet një kompensim për stimulimin e efektshmërisë në përputhje me deklaratën për politikën e kompensimit e cila përgatitet dhe zbulohet nga Komisioni i Auditimit i Bordit të Drejtorëve në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni.”.

Bordi i Drejtorëve i mëparshëm për një periudhë një (1) vjeçare ka pranuar kompensim financiar pa asnjë vendim paraprak të Komisionit Komunal të Aksionarëve, çka përbën shkelje të Nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të cilin po e citoj si në vijim: “2. Neni 20 i ligjit bazik, paragrafi 20.6 riformulohet si në vijim: 20.6. NP është përgjegjëse për pagimin e të gjithë kompensimit për drejtorët e saj vetëm nga pagesat e parapara me Vendimin e Aksionarit. Drejtorët e NP nuk do të marrin asnjë kompensim ose përfitim tjetër nga NP.”.

Njëjtë ka vepruar edhe Komisioni i Auditimit të cilët kanë kërkuar kompensim financiar pa vendim paraprak të Komisionit Komunal të Aksionarëve. Pra kemi pas një Bord dhe Komision të Auditimit të cilët kanë pranuar kompensim financiar pa vendim të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Për këtë arsye ne si Komision Komunal i Aksionarëve me datë 22.08.2022, kemi marr vendimin me të cilin anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të N.P.L “Përparimi” Sh. A, t’u caktohet kompensimi ashtu që ky vendim do të vlejë edhe për të gjitha bordet e ardhshme, të cilët do të veprojnë në këtë ndërmarrje.

1.4 MIRATIMI I STATUTIT TË N.P.L “PËRPARIMI” SH. A

Me datë 05.02.2021 ishte miratuar Statuti Nr. 5509/21 i N.P.L “Përparimi” Sh. A, nga ana e Komisionit Komunal paraprak. Gjatë funksionimit të ndërmarrjes, ishin vërejtur disa pengesa që ishin paraqitur nga statuti për arsye se i njëjti nuk ishte harmonizuar në tërësi me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Plotësim Ndryshimet e të njëjtit dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Me statutin e kaluar nuk ishin rregulluar në mënyrë të hollësishme se cilat janë veprimtaritë e ndërmarrjes, dhe nuk ishin të përshkruara ashtu si kërkohet me Librin për Klasifikimin e Veprimtarive Ekonomike (Nace Rev. 2), e cila është publikuar në kuadër të ARBK-së, ku ceken edhe kodet varësisht prej veprimtarive që ofron çdo shoqëri tregtare.

Me datë 14.10.2022, ne si Komision duke zbatuar Nenin 182 nën par. 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare të cilin po e citoj si në vijim: “1. Çështjet në vijim janë në kompetencën ekskluzive të aksionarëve dhe mund të vendosen vetëm nga aksionarët: 1.1.ndryshimi dhe plotësimi i statutit ose rregulloreve të Shoqërisë Aksionare;”, kemi miratuar Statutin e ri i N.P.L “Përparimi” Sh. A me të cilin ishte shfuqizuar Statuti i mëparshëm, meqë rast veprimtaritë që ofron tani dhe që mund të ofrojë ndërmarrja në të ardhmen janë përfshirë edhe në kuadër të Certifikatës së Biznesit të ndërmarrjes e të cilat janë si në vijim:

1.1 Veprimtaritë primare të ndërmarrjes janë si në vijim:

1.1.1 8130 Aktivitete shërbimi të mirëmbajtjes dhe kujdesit të shesheve mjedisit;

1.2 Veprimtaritë sekondare të ndërmarrjes janë si në vijim:

1.2.1 8121 Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave;

1.3 Veprimtaritë e tjera:

1.3.1 3700 Kanalizimi;

1.3.2 3811 Grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme;

1.3.3 5221 Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor

1.3.4 4941 Transporti rrugor i mallrave;

1.3.5 8122 Aktivitetet e tjera të pastrimit të ndërtesave dhe objekteve industriale

1.3.6 82.1 Zyrat Administrative dhe Aktivitetet mbështetëse;

1.3.7 4321 Instalimet elektrike;

1.3.8 9603 Shërbime funerali dhe aktivitetet e tjera lidhura me to;

1.3.9 8129 Aktivitetet e tjera të pastrimit;

Në tekstin e mësipërm vërehen veprimtaritë që ndërmarrja ofron dhe pret në të ardhmen t’i ofrojë. Përshkrimi i të njëjtave është bërë në harmoni Librin për Klasifikimin e Veprimtarive Ekonomike (Nace Rev. 2), e cila është publikuar në kuadër të ARBK-së. Dispozitat e tjera të statutit janë harmonizuar me ligjet në fuqi, po ashtu ku është dhënë mundësia që me anë të statutit të rregullohet një çështje ndryshe nga ana e Ligjit, është vepruar në atë formë. E rëndësishme që ky Statut është pranuar nga ana e ARBK-së, si një statut i ligjshëm, dhe në harmoni me Ligjet në fuqi.

1.5 AKTET E BRENDSHME TË NDËRMARRJES

Ndërmarrja ka vepruar në përputhshmëri me nenin 34.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ku thuhet se ndërmarrja duhet të ketë rregullore me të cilën rregullohet organizimi i brendshëm dhe puna e ndërmarrjes, meqë rast rregulloret të cilat janë miratuar dhe janë në fuqi në N.P.L “Përparimi” Sh. A, janë rregulloret² si në vijim:

1. Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës;
2. Rregullorja për Përgjegjësinë dhe Procedurat Disiplinore;
3. Rregullorja për Punën e Bordit të Drejtorëve;
4. Rregullorja mbi Përdorimin e Automjeteve Zyrtare;
5. Rregullorja për Marrëdhënien e Punës;
6. Rregullorja për Menaxhimin e Depos;
7. Kodi i Sjelljes dhe i Etikës;
8. Rregullorja për Shpenzimin e Parasë;
9. Rregullorja për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë;
10. Rregullorja për Rojet dhe Përgjegjësitë e tyre;
11. Rregullorja për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Marrëdhënien e Punës;
12. Rregullorja për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Përgjegjësitë dhe Procedurat Disiplinore;
13. Rregullorja për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Punën e Bordit të Drejtorëve;

Me rastin e miratimit të Rregulloreve të lart cekura janë marr për bazë ligjet dhe Rregulloret që rrjedhin nga ligjet si në vijim:

1. Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
2. Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
3. Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111;
4. Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
5. Ligji Nr. 03/L-212 i Punës;
6. Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë;
7. Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë së bashku me plotësim ndryshimet;
8. Rregullorja MF-NR. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare;

² Ndonëse ky raport përfshihet vetëm për vitin kalendarik 2022, disa rregullore që janë miratuar në vitin kalendarik 2023 janë përfshirë në kuadër të kësaj pjese të këtij raporti.

2. NUMRI I TË PUNËSUARVE NË FUND TË MUAJIT DHJETOR

Ndërmarrja në fund të muajit dhjetor për vitin kalendarik 2022 ka pasur të punësuar, që kanë qenë të angazhuar në njësi të ndryshme, shtatëdhjetë e nëntë (79) të punësuar kanë qenë të angazhuar në pozitën e punës “Sigurim Fizik”, shtatëdhjetë e tre (73) të punësuar kanë qenë të angazhuar në pozitën e punës “Pastrues i Zyrave dhe Objekteve”, nëntë (9) të punësuar kanë qenë të angazhuar në pozitën e punës “Mirëmbajtës të Hapësirave Publike”, ndërmarrja udhëhiqet nga “Kryeshefi Ekzekutiv”, me stafin menaxherial; “Sekretari/Këshilltari Korporativ” dhe “Zyrtari Kryesor Financiar”.

3. MARRËVESHJET E NDËRMARRJES ME KOMUNËN E VUSHTRRISË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNALE

Ndërmarrja gjatë vitit kalendarik 2022 ka ofruar shërbime për komunën e Vushtrrisë, në bazë të marrëveshjes paraprake deri me datë 15.05.2022. Marrëveshja e re është lidhur dhe nënshkruar me komunën me datë 16.05.2022, në të cilën marrëveshje janë paraparë se cilat janë ato shërbime të cilat i ofron ndërmarrja shërbime për komunën e Vushtrrisë.

Në pjesën e parë të muajit maj, menaxhmenti i ndërmarrjes ka negociuar vazhdimin e marrëveshjes me Komunën e Vushtrrisë, për kryerjen e shërbimeve komunale për Komunën e Vushtrrisë. Menaxhmenti përgjatë një (1) viti kishte analizuar pjesët në të cilën marrëveshja që ishte në fuqi të ndryshohej dhe të vendosen disa shërbime të cilat mund t'i marr përsipër ndërmarrja.

3.1 PASTRIMI I OBJEKTEVE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Njëra nga fushë veprimtaritë kryesore të ndërmarrje, për vitin kalendarik 2022 ka qenë pastrimi i objekteve dhe institucioneve të ndryshme publike që i përkasin Komunës së Vushtrrisë. Ndërmarrja ka marrëveshjen me Komunën e Vushtrrisë që të ofrojë shërbime në pastrimin e objekteve që janë nën pronësi të Komunës së Vushtrrisë, ku ne duhet të bëjë pastrimin e të gjitha hapësirave që gjenden në kuadër të objekteve.

Aktivitetet që ka ofruar ndërmarrja në fushën mirëmbajtjes-pastrimit të institucioneve publike përgjatë vitit kalendarik 2022 kanë qenë si në vijim:

1. Kryerjen e shërbimeve të pastrimit të të gjitha hapësirave të tri (3) shkollave të arsimit të mesëm, dhe arsimit parashkollor, si dhe objektet përcjellëse të tyre.

2. Kryerjen e shërbimeve të pastrimit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në qendrat e mjekësisë familjare dhe ambulanteve të mjekësisë familjare në të gjithë Komunën e Vushtrrisë.
3. Kryerjen e shërbimeve të pastrimit të të gjitha hapësirave të objekteve të Administratës së Komunës që përfshinë Objektin e Komunës si dhe objektet tjera të administratës komunale jashtë objektit të komunës si Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina", Palestra Sportive në Vushtri, ajo në Samadrexhë, Muzeu i Qytetit, Qendra Rinore "Naxhije dhe Fahri Buqinca", dhe Qendrën për Punë Sociale, përfshirë pastrimin e xhamave të jashtëm.
4. Pastrimin e xhamave të jashtëm të Objektit të Komunës, dhe objekteve tjera të Komunës.
5. Pastrimin e xhamave të jashtëm të objekteve të komunës;

3.2 SIGURIMI FIZIK

Ndërmarrja në bazë të marrëveshjes që ka me komunën e Vushtrrisë ofron shërbimin themelor të sigurimit fizik të objekteve të institucioneve publike të komunës (Objektet e Arsimit, Shëndetësisë dhe Administratës së Komunës). Pra ndërmarrja bën sigurimin fizik të të gjitha objekteve arsimore, të objekteve shëndetësore, të administratës së komunës dhe objekteve përcjellëse të tyre. Ndërmarrja gjatë vitit kalendarik 2022 ka ofruar në tërësi shërbimet që ka pasur të kontraktuara me Komunën e Vushtrrisë, meqë rast gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë thyerje të asnjë objekti, dhe nuk kemi pas asnjë ankesë nga autoriteti kontraktues. Numri i të punësuarëve që është paraparë me planin e biznesit nuk është tejkaluar, ka qenë brenda suazave të kërkuara në bazë të Planit të Biznesit. Ndërmarrja këtë shërbim e ofron në bazë të prokurimit të brendshëm ndër institucional dhe këtë shërbim e ofron për aksionarin e ndërmarrjes.

Ndërmarrja edhe në vitin 2022 ka vazhduar aktivitete e saja në mirëmbajtjen e hapësirave publike në komunën e Vushtrrisë duke u bazuar në marrëveshjen bazë³ dhe marrëveshjen e nënshkruar në vitin 2022⁴.

Ndërmarrja ka vazhduar aktivitetet për çdo muaj të gjitha i gjeni të bashkangjitura në tabelat në vijim.

4. SHËRBIMET E MIRËMBAJTJES SE HAPËSIRAVE PUBLIKE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

³ Në marrëveshjen për kryerjen e shërbimeve komunale në mes ndërmarrjes dhe komunës me nr. protokollit 542/21, të datës 17.05.2021.

⁴ Në marrëveshjen për kryerjen e shërbimeve komunale në mes ndërmarrjes dhe komunës me nr. protokollit 451/22, të datës 16.05.2022.

Mirëmbajtja e Hapësirave Publike Komunale”, duke ofruar këto shërbime ka për synim kryesor ruajtjen dhe mbrojtjen e ambientit, andaj bazuar ne kete ndërmarrja gjatë vitit kalendarik 2022 ka zgjeruar gamën e shërbimeve të cilat janë interes per qytetaret e komunës se Vushtrrisë si në vijim:

1. Mirëmbajtjen e shëtitorës dhe anësorëve afër Lumit Silnica duke përfshirë pjesën e kubëzuar me gurë;
2. Mbjelljen e drunjve dekorativ;
3. Krasitjen e drunjve dekorativ;
4. Ujitja e drunjve dekorativ;
5. Mbjellja dhe ujitja e luleve;
6. Prashitjen e luleve
7. Mbjelljen e barit artificial;
8. Pastrimi nga bora;
9. Vendosjen e flamujve (së bashku me shtiza) kombëtar, shtetëror apo të aleatëve në qyteti, memorialë, lapidare, varreza të dëshmorëve dhe martirëve.
10. Bartjen e inventarit të demoluar nga objektet e komunës.
11. Pastrimi i përroskave dhe kanaleve në Komunën e Vushtrrisë.
12. Bartjen e kontejnerëve të reciklimit.
13. Largimi i deponive ilegale;
14. Debllokimi i kanalizimeve;

AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË MUAJIT DHJETOR 2021

Në tabelën nr. 3 gjeni të bashkangjitura të gjitha aktivitetet që janë përfunduar gjatë muajit Dhjetor 2021 .

Tabela nr. 3: *Aktivitetet e realizuara në mirëmbajtjen e hapësirave publike gjatë muajit Dhjetor 2021;*

Muaji	Lloji i Aktivitetit	Sipërfaqe/Sasi
Dhjetor 2021	Krasitja e Drunjve Dekorativ	670 Copë
Dhjetor 2021	Kositja dhe mirëmbajtja e hapësirave publike	24,600.00 m ²
Dhjetor 2021	Pastrimi i lumenjve (Tërstena dhe Podranqe)	15,375 .00m ²

AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË MUAJIT JANAR 2022

Tabela nr.4. *Aktivitetet e realizuara në mirëmbajtjen e hapësirave publike gjatë muajit Janar 2022;*

Muaji	Lloji i Aktivitetit	Sipërfaqe/Sasi
Janar	Krasitja e Drunjve Dekorativ	42 copë
Janar	Kositja dhe mirëmbajtja e hapësirave publike	25,000.00 m ²
Janar	Pastrimi i lumenjve (Tërstena dhe Podranqe)	12,100.00 m ²
Janar	Pastrimi nga Bora i trotuareve, shesheve etj.	24,000.00 m ²

AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË MUAJIT SHKURT 2022

Ndërmarrja për punën e kryer në fushën e shërbimeve të mirëmbajtjes të hapësirave publike komunale për muajin Shkurt i ka realizuar këto aktivitete si në vijim:

Tabela nr. 5. Aktivitetet e realizuara në mirëmbajtjen e hapësirave publike gjatë muajit Shkurt 2022;

Muaji	Lloji i Aktivitetit	Sipërfaqe/Sasi
Shkurt	Krasitja e Drunjve Dekorativ	47 copë
Shkurt	Kositja dhe mirëmbajtja e hapësirave publike	82,616.50 m ²
Shkurt	Pastrimi i lumenjve (Tërstena dhe Podranqe)	14,854.73 m ²

AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË MUAJIT MARS 2022

Ndërmarrja për punën e kryer në fushën e shërbimeve të mirëmbajtjes të hapësirave publike komunale për muajin Mars i ka realizuar këto aktivitete si në vijim:

Tabela nr.6. Aktivitetet e realizuara në mirëmbajtjen e hapësirave publike gjatë muajit Mars 2022;

Muaji	Lloji i Aktivitetit	Sipërfaqe/Sasi
Mars	Krasitja e Drunjve Dekorativ	19 copë

Mars	Kositja dhe mirëmbajtja e hapësirave publike	107,554.10 m ²
Mars	Pastrimi i lumenjve (Tërstena dhe Podranqe)	10,767.23 m ²

AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË MUAJIT PRILL 2022

Ndërmarrja për punën e kryer në fushën e shërbimeve të mirëmbajtjes të hapësirave publike komunale për muajin Prill i ka realizuar këto aktivitete si në vijim:

Tabela nr.7: Aktivitetet e realizuara në mirëmbajtjen e hapësirave publike gjatë muajit Prill 2022;

Muaji	Lloji i Aktivitetit	Sipërfaqe/Sasi
Prill	Kositja dhe mirëmbajtja e hapësirave publike	93,632.00 m ²
Prill	Pastrimi i lumenjve (Tërstena dhe Podranqa)	15,933.71 m ²

AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË MUAJIT MAJ 2022

Ndërmarrja për punën e kryer në fushën e shërbimeve të mirëmbajtjes të hapësirave publike komunale për muajin Maj i ka realizuar këto aktivitete si në vijim:

Tabela nr. 8. Aktivitetet e realizuara në mirëmbajtjen e hapësirave publike gjatë muajit Maj 2022;

Muaji	Lloji i Aktivitetit	Sipërfaqe/Sasi
Maj	Kositja dhe mirëmbajtja e hapësirave publike	127,877.54 m ²
Maj	Pastrimi i lumenjve (Tërstena dhe Podranqa)	11,002.20 m ²
Maj	Ujitja e Luleve	17,406.09 m ²
Maj	Ujitja e Drunjve Dekorativ	450 copë
Maj	Mbjellja e Luleve	9543 copë

AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË MUAJIT QESHOR 2022

Ndërmarrja për punën e kryer në fushën e shërbimeve të mirëmbajtjes të hapësirave publike komunale për muajin Qershor i ka realizuar këto aktivitete si në vijim:

Tabela nr.9. Aktivitetet e realizuara në mirëmbajtjen e hapësirave publike gjatë muajit Qershor 2022;

Muaji	Lloji i Aktivitetit	Sipërfaqe/Sasi
Qershor	Kositja dhe mirëmbajtja e hapësirave publike	103,633.09 m ²
Qershor	Pastrimi i lumenjve (Tërstena dhe Podranqe)	11,989.03 m ²
Qershor	Ujitja e Luleve	15,802.6 m ²
Qershor	Ujitja e Drunjve Dekorativ	231 Copë
Qershor	Mbjellja dhe blerja e Luleve	15,457.00 copë

AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË MUAJIT KORRIK 2022

Ndërmarrja për punën e kryer në fushën e shërbimeve të mirëmbajtjes të hapësirave publike komunale për muajin Korrik 2022 i ka realizuar këto aktivitete si në vijim:

Tabela nr.10. Aktivitetet e realizuara në mirëmbajtjen e hapësirave publike gjatë muajit Korrik 2022;

Muaji	Lloji i Aktivitetit	Sipërfaqe/Sasi
Korrik	Kositja dhe mirëmbajtja e hapësirave publike	122,129.38 m ²
Korrik	Pastrimi i lumenjve (Tërstena dhe Podramqe)	18,628.44 m ²
Korrik	Ujitja e luleve	14,396.7 m ²
Korrik	Ujitja e Drunjve Dekorativ	1,828.00 Copë
Korrik	Prashitja e Drunjve Dekorativ	261.00 Copë

AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË MUAJIT GUSHT 2022

Ndërmarrja për punën e kryer në fushën e shërbimeve të mirëmbajtjes të hapësirave publike komunale për muajin Gusht 2022 i ka realizuar këto aktivitete si në vijim:

Tabela nr. 11. Aktivitetet e realizuara në mirëmbajtjen e hapësirave publike gjatë muajit Gusht 2022;

Muaji	Lloji i Aktivitetit	Sipërfaqe/Sasi
Gusht	Kositja dhe mirëmbajtja e hapësirave publike	106.249.24 m ²
Gusht	Pastrimi i lumenjve (Tërstena dhe Podranqe)	12,427.51 m ²
Gusht	Ujitja e luleve	403.60 m ²
Gusht	Ujitja e Drunjve Dekorativ	2,295.00 Copë
Gusht	Prashitja e Drunjve Dekorativ	92.00 Copë

AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË MUAJIT SHTATOR 2022

Ndërmarrja për punën e kryer në fushën e shërbimeve të mirëmbajtjes të hapësirave publike komunale për muajin Shtator 2022 i ka realizuar këto aktivitete si në vijim:

Tabela nr. 12. Aktivitetet e realizuara në mirëmbajtjen e hapësirave publike gjatë muajit Shtator 2022;

Muaji	Lloji i Aktivitetit	Sipërfaqe/Sasi
Shtator	Kositja dhe mirëmbajtja e hapësirave publike	72,307.41 m ²
Shtator	Pastrimi i lumenjve (Tërstena dhe Podranqe)	18,078.72 m ²

AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË MUAJIT TETOR 2022

Ndërmarrja për punën e kryer në fushën e shërbimeve të mirëmbajtjes të hapësirave publike komunale për muajin Tetor 2022 i ka realizuar këto aktivitete si në vijim:

Tabela nr.13. Aktivitetet e realizuara në mirëmbajtjen e hapësirave publike gjatë muajit Tetor 2022;

Muaji	Lloji i aktivitetit	Sipërfaqja/Sasia
Tetor	Kositja dhe mirëmbajtja e hapësirave	92,925.28 m ²
Tetor	Pastrimi i lumenjve (Tërstena dhe Podranqe)	12,435.25 m ²
Tetor	Ujitja e luleve	326.40 m ²
Tetor	Prashitje e drunjve	70.00 Copë

Tetor	Debllokimi dhe pastrimi i gypave te kanalizimit Φ 300	6 Copë
Tetor	Debllokimi dhe pastrimi i gypave te kanalizimit Φ 150	6 Copë
Tetor	Incizimi i gypave të kanalizimit me kamerë dhe identifikimi i problemeve	5 Copë

AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË MUAJIT NËNTOR 2022

Ndërmarrja për punën e kryer në fushën e shërbimeve të mirëmbajtjes të hapësirave publike komunale për muajin Nëntor 2022 i ka realizuar këto aktivitete si në vijim:

Tabela nr. 14. Aktivitetet e realizuara në mirëmbajtjen e hapësirave publike gjatë muajit Nëntor 2022;

Muaji	Lloji i aktivitetit	Sipërfaqja/Sasia
Nëntor	Kositja dhe mirëmbajtja e hapësirave publike	109,608.89 m ²
Nëntor	Pastrimi i lumenjve (Tërstena dhe Podranqe)	21,648.32 m ²
Nëntor	Ujitja e luleve	333.80 m ²
Nëntor	Krasitja e drunjve	19.00 Copë

AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË MUAJIT DHJETOR 2022

Ndërmarrja për punën e kryer në fushën e shërbimeve të mirëmbajtjes të hapësirave publike komunale për muajin Dhjetor 2022 i ka realizuar këto aktivitete si në vijim:

Tabela nr. 15. Aktivitetet e realizuara në mirëmbajtjen e hapësirave publike gjatë muajit Dhjetor 2022;

Muaji	Lloji i aktivitetit	Sipërfaqe/Sasia
Dhjetor	Kositja dhe mirëmbajtja e hapësirave publike	86,335.12 m ²
Dhjetor	Debllokimi dhe pastrimi i kanalizimeve	15.00 Copë

Dhjetor	Grumbullimi dhe bartja e mbeturinave të riciklueshme	867.00 Kontejnerë
---------	--	-------------------

Tabela 16. Totali i shërbimeve të ofruara në mirëmbajtjen e hapësirave publike gjatë vitit 2022 të shprehura në njësi matëse ;

Aktivitete	Sipërfaqe/Sasia	Njësia matëse
Kositja dhe mirëmbajtja e hapësirave publike	1,154,468.55	m ²
Krasitja e drunjve dekorativ	797	Cope
Pastrimi i lumenjve Podramqë dhe Terstena	175,240.14	m ²
Mbjellja e luleve	25,000.00	Cope
Ujitja e luleve	48,669.19	m ²
Ujitja e drunjve dekorativ	4,804.00	Cope
Prashitja e drunjve dekorativ	423.00	Cope
Pastrimi nga Bora i trotuareve, shesheve	24,000.00	m ²
Debllokimi dhe pastrimi i kanalizimeve dhe incizimi i gypave	32	Cope
Grumbullimi dhe bartja e mbeturinave të riciklueshme	867	Kontinjerë

Tabela 17. Çmimet sipas marrëveshjeve për aktivitete e kryera në fushën e mirëmbajtjes së hapësirave publike gjatë vitit 2022;

Aktivitete	Marrëveshja e datës 17.05.2021,nr. 542/21	Marrëveshja e datës 16.05.2022 nr. 625-1/22	Marrëveshja e datës 16.11.2022,nr. 1451/22
Kositja dhe mirëmbajtja e të gjitha hapësirave gjelbëruese (m ²)	0.09 €	0.09 €	0.09 €
Krasitja e drunjve dekorativ (copë)	2.30 €	2.30 €	2.30 €
Mbjellja e luleve (copë) dhe blerja	0.08 €	0.50 €	0.50 €

Ujitja e drunjve dekorativ(copë)	0.50 €	0.50 €	0.50 €
Ujitja e luleve dhe hapësirave përreth (m ²)	0.30 €	0.30 €	0.30 €
Mirëmbajtja e lumit "Tërstena" dhe" Podranqa" (m ²)	0.30 €	0.30 €	0.30 €
Mbjellja e barit artificial	1.30 €	1.30 €	1.30 €
Pastrimi nga bora shesheve dhe trotuareve (m ²)	0.08 €	0.20 €	0.20 €
Prashitja e drunjve dekorativ (copë)	-	0.30 €	0.30 €
Debllokimi I kanalizimeve (copë)	-	-	90.00 €
Prashitja e luleve (m ²)	-	-	0.30 €
Grumbullimi I mbeturinave të reciklueshme (kontinierë)	-	-	1.00 €
Vendosja e flamujve (copë)	-	-	2.00 €
Largimi I deponive ilegale me bager	-	-	70.00 €
Largimi I deponive ilegale me kamion	-	-	50.00

Tabela nr,18 te hyrat nga drejtorit;

Drejtoritë	Vlera
Drejtoria e Arsimit	401,975.00 €
Drejtoria e Administratës	171,416.00 €
Drejtoria e Shëndetësis	145,779.00 €
Drejtoria e Shërbimeve Publike	211,348.64 €
Totali;	930,518.64 €⁵

5.SHPENZIMET E NDËRMARRJES GJATË VITI 2022

Ndërmarrja gjatë periudhës raportuese 2022 përveç të hyrave që ka realizuar, në të njëjtën kohë ka pasur dhe shpenzime siç janë në vijim:

⁵ Vlera e faturave me TVSH

- ✓ Shpenzimet për paga dhe mëditjeve;
- ✓ Shpenzimet për mjete dhe pajisje;
- ✓ Shpenzimet për mallra dhe shërbimet;

Tabela nr. 19. Shpenzimet e pagave bruto dhe mëditjeve për gjatë vitit 2022;

<i>Muaji</i>	Totali Bruto	<i>Paga Neto</i>	<i>Kontributet nga punëtori dhe tatimi ne pagë</i>	<i>Kontributi nga punëdhënësi</i>
<i>Janar</i>	52,143.74€	45,130.48€	4,502.34€	2,510.92€
<i>Shkurt</i>	50,836.29€	44,037.53€	4,350.10€	2,448.66€
<i>Mars</i>	53,421.35€	46,318.96€	4,530.63€	2,571.76€
<i>Prill</i>	56,082.35€	48,593.63€	4,790.24€	2,698.48€
<i>Maj</i>	56,486.65€	48,994.18€	4,802.62€	2,689.85€
<i>Qershor</i>	55,405.20€	48,090.96€	4,675.90€	2,638.34€
<i>Korrik</i>	54,918.77€	47,734.33€	4,569.27€	2,615.17€
<i>Gusht</i>	57,934.07€	50,232.84€	4,942.48€	2,758.75€
<i>Shtator</i>	58,875.96€	51,149.88€	4,922.44€	2,803.64€
<i>Tetor</i>	60,554.87€	52,566.15€	5,105.16€	2,883.56€
<i>Nëntor</i>	63,228.44€	54,869.34€	5,348.25€	3,010.85€
<i>Dhjetor</i>	63,809.12€	55,384.75€	5,385.81€	3,038.56€
Totali:	683,696.81€	593,103.03€	57,925.24€	32,668.54€
Totali me kontribute	683,696.81€			

PASQYRAT E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR VITIN KALENDARIK 2022

**Tabela,37. Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve
2022**

Te hyrat

Te hyrat nga shërbimi për Sigurim dhe Pastrim	589,097.45
Te hyrat nga mirëmbajtja e hapësirave publike (Ujitja, mbjellja dhe prashitja e luleve, prashitja e drunjve dekorativ etj)	49,680.68
Te hyrat nga krasitja e drunjeve dekorativ	2,622.89
Te hyrat nga kositja dhe mirëmbajtja	102,368.90
Te hyrat nga pastrimi i lumenjeve	51,892.00
Te hyrat nga pastrimi i bores (trotuar dhe sheshe)	1,920.00
Te hyra nga grumbullimi i mbeturinave te reciklueshme	867.00
Te hyrat nga deblokimi i kanalizmit	4,429.66
Nota Kreditore/Debitore/te dhena dhe marra	-1,536.72
Te hyrat	801,341.86

Shpenzimet

Shpenzimet e pagave bruto	651,028.27
Shpenzimet e kontributeve pensionale	32,668.48
Shpenzimet e zyrës dhe administrates	3,045.92
Shpenzimet për Zyre(uje dhe gjëra të tjera)	128.12
Shpenzimet e telefonit dhe internetit	1,276.84
Shpenzimet e pastrimit(Higjiena)	1,105.50
Shpenzimet per mbeturina	212.64
Shpenzimet Juridike dhe keshillime financiare(Programi I kontabilitet dhe audtimi I pasyrave financiare)	1,513.08
Shpenzimet e taksave komunale	110.00
Shpenzimet per asete te vogla	13,872.00
Shpenzimet e derivateve	7,644.24
Shpenzimet e antarsimeve (Pam Kos)	1,100.00
Shpenzimet e mirembajtjes dhe riparimeve të automjeteve	2,540.19
Shpenzimet e provizioneve bankare	909.25
Shpenzimet e reklames dhe shpalljeve për publikim te konkurseve	1,000.00
Shpenzimet e reprezentacionit	507.18
Shpenzimet e udhëtimit jasht vendit	1,537.91
Shpenzime te tjera operative	3,716.87
Shpenzimet	723,916.49

Shpenzimet e zhvleresimit

Shpenzimet e zhvleresimit kat II 20% 11,678.10

Shpenzimet e zhvleresimit 11,678.10**Jashte bilancore****Zërat jashtë bilancorë**

Shpenzimet e papranuara_atk 2,681.09

Zërat jashtë bilancorë 2,681.09

Fitimi para tatimit: 65,747.27

Tatimi: 6,574.73

Fitimi pas tatimit: 59,172.54

Pozicionet jashte-bilancore: 2,681.09

Fitimi i periudhes: 56,491.45**Tabela nr. 21: Llogaritja e TVSH-së gjatë vitit 2022 të shprehura në euro;**

Muaji	TVSH në shitje(Llogaritur)	TVSH në blerje (Zbritshëm)	TVSH për pagesë
Janar 2022	3,668.00	1,736.65	1,931.35
Shkurt 2022	4,969.12	5,390.59	(421.47)
Mars 2022	4,796.00	115.62	4,680.38
Prill 2022	12,382.41	175.65	12,206.76
Maj 2022	12,610.30	2,918.98	9,691.32
Qershor 2022	12,493.37	419.92	12,073.45
Korrik 2022	12,760.46	395.67	12,364.79
Gusht 2022	11,445.63	337.65	11,107.98
Shtator 2022	11,282.63	284.45	10,998.18
Tetor 2022	11,482.63	410.22	11,072.41
Nëntor 2022	12,609.55	2,834.90	9,774.65
Dhjetor 2022	17,146.59	482.73	16,663.86
Totali:			112,143.66

Në tabelën e mësipërme gjeni të bashkangjitur llogaritjen e TVSH-së gjatë viti 2022 e cila është paguar e gjitha në vitin 2022 përveç muajit Dhjetor 2022 është paguar me datën 20.01.2023 për arsye të afateve ligjore të ATK-së. Të gjithë muajt kanë qenë pagesë përveç muajit Shkurt I cili ka qenë në kreditim, ky kreditim në vlerë prej 421.47 euro është zbritur në muajin Mars. Gjatë viti 2022 kemi bërë parapagimet për çdo tre muajor për planifikim të tatimit në fitim për vitin 2022 në vlerë prej 4,756.92 Euro, prej të cilave 3,240.96 Euro është paguar gjatë vitit 2022 ndërsa vlera prej 1,515.96 Euro është paguar në Janar të viti 2023 për arsye të

afateve ligjore të ATK-së ndërsa pjesa tjetër e tatimit ne fitim do të paguhet deri me datën 31.03.2023. Viti 2021 ka qenë viti i pare i operimit të ndërmarrjes, pasi që fillojë punën nga muaji Maj 2021 prandaj për planifikimin për vitin 2022 të hyrave dhe shpenzimeve nuk kemi mundur të bazohemi edhe aq shumë në vitin paraprak sepse ka qenë vetëm gjysma e viti operim. Andaj duke u bazuar në tekstin e mësipërm ne mendojmë se kemi arritur kënaqshëm të realizojmë planifikimin për vitin 2022.

Tabela nr. 22: Realizimi dhe planifikimi për vitin 2022, të shprehura në euro dhe përqindje;

I. Të hyrat	Realizimi 2022	Planifikimi 2022
Të hyrat e faturuara për shërbimet e Sigurimit Fizik dhe Pastrimin e Zyrave dhe Objekteve	589,097.45	588,000.00
Të hyrat e faturuara për shërbimet e Mirëmbajtjes së hapësirave Publike	213,781.13	222,222.20
Subvencionet	90,000.00	00.00
Gjithsej të hyrat	892,878.58	810,222.20
II Shpenzimet		
Pagat Bruto:...	683,696.75	669,690.00
Derivatet :....	7,644.24	5,400.00
Kosto e komunikimit	1,276.84	1,464.00
Mirwmbajtja dhe riparimet ..	2,540.19	40,000.00
Uniforma pwr punwtor...	2,674.64	6,600.00
Mjete Higjienike...	1,105.50	68,470.40
Shpenzimet për zyre dhe administratë	8,954.10	10,000.00
Pajisjet Kompjuterike për staf	1,510.04	3,000.00
Shpenzimet tjera operative	14,514.19	6,375.00
Gjithsej Shpenzime.....	723,916.49	810,999.40

6.LETRA E MENAXHMENTIT DHE OPINIONI I AUDITIMIT TË JASHTËM

Pas përfundimit të çdo viti kalendarik pasqyrat vjetore financiare i nënshtrohet një auditimi të jashtëm vjetor dhe objektiv nga një auditor i pavarur, kompetent dhe i kualifikuar ashtu si kërkohet me nenin 19 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-08 për Ndërmarrjet Publike të cilin po e citoj si në vijim: *“Neni 33 i ligjit bazik paragrafi 33.1. riformulohet si në vijim: 33.1. Pasqyrat Vjetore Financiare të çdo Ndërmarrje Publike i nënshtrohen një auditimi të jashtëm të paraparë me ligj në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtare të auditimit. Ky auditim kryhet nga një auditor i pavarur, kompetent dhe i kualifikuar. Produkti përfundimtar i një auditimi të tillë duhet të jetë një opinion mbi vërtetësinë për Pasqyrat Vjetore Financiare përfshirë këtu edhe Letër Menaxhmentin.”*

Pasqyrat vjetore financiare për vitin kalendarik 2022 i janë nënshtuar auditimit të jashtëm. Auditori i Jashtëm i është drejtuar ndërmarrjes pas Auditimit të Pasqyrave vjetore Financiare ku ka shprehur opinionin se Pasqyrat vjetore Financiare janë hartuar në përputhje me rregullat dhe parimet e kontabilitetit dhe se paraqesin në mënyrë të drejtë gjendjen financiare të ndërmarrjes për vitin kalendarik 2022. Meqë rast më poshtë mund të shihni se letrën e menaxhmentit të ndërmarrjes, një ashtu dhe opinionin e Auditorit të Jashtëm të vulosur dhe të nënshkruar.

7.PËRFUNDIMI

1. Komisioni Komunal i Aksionarëve ka arrit të bëjë vlerësimin e punës së Bordit të Drejtorëve i zgjedhur 2021, dhe në bazë të vlerësimit ka ardh në përfundim se të njëjtit nuk po i përmbushin detyrimet që kanë në bazë të Ligjit dhe te njëjtit janë shkarkuar.
2. Komisioni Komunal i Aksionarëve ka emëruar Bordin e Përkohshëm të Drejtorëve, me qëllim që të ruhet stabiliteti i ndërmarrjes.
3. Komisioni Komunal i Aksionarëve ka marr vendim që Bordit të Drejtorëve t’u caktojë kompensimin financiar ashtu si kërkohet në bazë të Ligjeve në fuqi.
4. Komisioni Komunal i Aksionarëve ka miratuar Statutin e ri të N.P.L “Përparimi” Sh. A.



Quatra Audit Int. LLC.
A: Str. Nena Tereza, H2-1
T: +383 (0) 44/377-873
E: lulzimkraniqu@gmail.com
W: www.quatra-ks.com

RAPORT I AUDITORËVE TË PAVARUR

Për aksionarët dhe menaxhmentin e Ndërmarrje Publike Lokale Përparimi SH.A.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Ndërmarrje Publike Lokale Përparimi SH.A. ('Kompania') të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2021 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitive financiare të Kompanisë me 31 dhjetor 2021 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga kompania në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkobëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Ne besojmë se evidanca e përftuar e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinion.

Çështje tjera

- Ne tërheqim vëmendjen te Shënimi 1 - 'Informacioni i Përgjithshëm' i pasqyrave financiare, i cili përshkruan të dhënat bazë për ndërmarrjen, duke përfshirë datën e themelimit të ndërmarrjes. Kompania është themeluar më datë 12.02.2021 si Shoqëri aksionare. Meqenëse viti i parë raportues është më datë 31 janar 2021, biznesi nuk ka përgaditur pasqyra financiare për vitin paraprak dhe si rezultat pasqyrat financiare për vitin krahasues (paraprak) nuk përmbajnë të dhëna financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar si pasojë e kësaj çështje.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF dhe për kontrolle të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompanisë të vijojë sipas hipotezës së vijlmesisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijlmesisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijlmesit përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likullojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprimit në këtë mënyrë. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijmësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfarido mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Lulzim Krasniqi, Auditor LIGJOR, CertIFR, VLP
Partner, QUATRA AUDIT Int. LLC

Prishtinë,
24.06.2022

P: +383 (0) 44 377 873 ♦ E: lulzimkrasniqi@gmail.com
A Sheshi Nëna Terezë, H1, Nr.2, Prishtina, Kosovo
Licenca KKRf Nr: 80 ♦ Nr.Scaak: 2088





Ndërmarrje Publike Lokale Përparimi SH.A.
Rruga Gjergj Kastrioti Skënderbeu, nr.82
Vushtri, Kosovë
NUI: 811507758

Deklaratë e Pajtueshmërisë

- Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 dhjetor 2021 -

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 2021 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e ligjit 06-/L-065 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.


Fadil Bahtiri
Kryeshf Ekzekutiv





Valmira Xhafa Zekolli
Zyrtare Kryesore Financiare



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIS

DATË: 07/11/2023

PËR: Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

PROPOZUES: Kryetari i Komunës, z. Ferit Idrizi 

HARTUES: Drejtorja për Buxhet dhe Financa, drejtor z. Isuf Jashari 

TEMA: Propozim-vendim

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja “d”, nenit 40, paragrafi 2 pika “c” të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe neni 9 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimit në Pronën e Paluajtshme (Ligji Nr. 08/L-224), si dhe në bazë të nenit 19, paragrafi 1 pika 1.5 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me datë: _____ 2023 merr këtë:

VENDIM PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE TË PRONAVE

1. Me këtë vendim bëhet caktimi i normave tatimore për të gjitha kategoritë e pronave me përjashtim të kategorisë pronë publike, dhe atë si në vijim:

Lloji i pronës	Norma e tatimit në %
Pronë rezidenciale (banesë-apartmant)	0,20
Njësi rezidenciale-parcelë	0,12
Pronë rezidenciale - shtëpi	0.20
Pronë komerciale	0.21
Njësi komerciale-parcelë	0,18
Pronë industriale	0.20
Njësi industriale-parcelë	0,18
Pronë bujqësore	0.10

Njësi bujqësore-parcelë	0,10
Njësi pyjore parcelë	0,12
Pronat e pa-meremetuara dhe jo të gatshme për banim	0.10
Garazhet	0.15
Objektet e braktisura	0.10
Pronat komerciale (pishinat, fushat sportive etj).	0.21
Pronat e pa-meremetuara dhe jo të gatshme komerciale	0.20

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit si dhe plotësim-ndryshimin e Ligjit të Tatimit në Pronën e Paluajtshme, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, karshi aprovimit të Buxhetit të Komunës së Vushtrisë, nga ana e kuvendit, është e obliguar të procedojë me propozim për aprovimin e nivelit të normave të tatimit në pronën e paluajtshme komfor dispozitave dhe kritereve të përcaktuar me dispozitat ligjore.

Nga të cekurat më lartë i propozojmë kuvendit të komunës që ta aprovojë këtë propozim-vendim si në dispozitiv.



Republika e Kosovës
Republika Kosova • Republic of Kosova



Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn • Municipality of Vushtrri
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

DATË/A	07.11.2023
REFERENC-Ë:	08Nr.613
PËR/ZA/TO:	Kryesuesen e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë Znj. Melihate Basholli-Latifi, Anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa, Anëtarët e Kuvendit Komunal
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetarit të Komunës z.Ferit Idrizi
NGA/OD/FROM:	Drejtorë e drejtorisë Fortuna Krasniqi-Spahi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal

Të nderuar,

Bazuar në Planin e punës së Kuvendit Komunal e cila ka të bëjë me Informatën lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal e cila përfshinë periudhën nga Janari i këtij viti, DUMM ju informon se sa i përket Planit Zhvillimor Komunal i aprovuar me vendim nr.01Nr.126/17 të dt.04.05.2017 nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë për periudhën 2016-2024, i cili është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës përfshinë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë prej së paku tetë (8) vjeçare.

Gjatë periudhës Janar – Nëntor 2023, lidhur me zbatimin e objektivave të parashikuara në planin e lartcekur kryesisht janë mbajtur takimet e organizuara nga sektori i planifikimit urban për çështjet e rregullimit urban pjesëmarrja në konferenca të organizuara nga niveli qendror dhe grupe tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, takimet e rregullta me komunitetet e zonave të ndryshme, propozimet e ndryshme për rregullim, takimet e rregullta me nivelin qendror si dhe rritja e bashkëpunimit në mes të DUMM me drejtoritë tjera për qëllim të rritjes së profesionalizmit dhe efikasitetit për realizimin e qëllimeve të përbashkëta si dhe në muajin shtator kemi hartuar propozim-vendimin për iniciimin e procedurave për Hartimin e PZHK-së pasi që e njeta në vitin 2024 i skadon afati .

DUMM ka zbatuar Planin Zhvillimor Komunal në çdo kërkesë nga zyrtaret përgjegjës gjatë shqyrtimit të kërkesave të pranuar që kanë të bëjnë me ndërtime dhe informime tjera rreth destinimit të parcelave kadastrale, janë udhëzuar me destinimin e përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal po ashtu kërkesat e parashtruara për marrjen e Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore dhe Lejeve për Rrënimin e objekteve për kategorinë e parë (I) dhe të dytë (II) janë trajtuar me përkushtim të lartë dhe në harmoni të plotë me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) 2016-2024.



Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova



Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn - Municipality of Vushtrri
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

DATE/A	06.11.2023
REFERENC-Ë:	18 Nr.61
PËR/ZA/TO:	KPF-ca dhe Kuvendin e Komunës Znj. Melihate Basholli-Latifi, kryesuese
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi 
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë z. Remzi Ahmeti, drejtor 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale

Të nderuar,

Bazuar në Planin e Punës së Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë dhe të Kuvendit Komunal, paraqesim Informatë lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore dhe lokaleve afariste në pronësi të komunës për periudhën janar-tetor 2023.

Për momentin në menaxhim kemi 25 Kontrata për dhënien në shfrytëzim të tokave bujqësore në pronësi të komunës dhe 28 Kontrata për dhënien me qira të lokaleve afariste në pronësi të komunës.

Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, bazuar në Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës të Komunës, ka përpiluar dhe publikuar në Ueb-faqen e Komunës Listën e përgjithshme të pronave komunale.

Gjithashtu, kemi hartuar Listën e veçantë të pronave të komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2023, e cila listë është miratuar nga Kuvendi i Komunës.

Gjatë periudhës janar-nëntor 2023 nuk janë lidhur kontrata të reja për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

Deri më tani vlera e inkasuar nga pronat komunale të dhëna në shfrytëzim për periudhën 01.01.2023 deri më 01.11.2023 arrin shumën prej 17776.81€.

Me respekt!





REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

Drejtoria për Shërbime Publike

Datë/a:	07.11.2023
Për:	KPF, Kuvendin Komunal
Përmes:	Kryetari i Komunës Ferit Idrizi 
Nga:	Drejtori i Drejtorisë Benjamin Shala 
Tema:	Informatë për menaxhimin e mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë

Të nderuar anëtar të komitetit për politikë dhe financa, anëtar të kuvendit,

Që nga hyrja në fuqi të Ligjit për Mbeturinat (Ligji nr.04/L-060), sipas politikave të Qeverisë, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve si dhe shërbimet tjera të pastrimit, i janë deleguar autoriteteve lokale. Pra ky ligj ka deleguar më shumë autoritet dhe përgjegjësi të qeverisja lokale sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Në këtë kuadër janë qartësuar edhe përgjegjësitë dhe detyrimet e komunës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të implementimit të kësaj infrastrukture ligjore, krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë përmes menaxhimit të plotë të mbeturinave, pat hartuar dhe miratuar në kuvend, Planin për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2026 brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë si dhe Rregulloren për menaxhim të mbeturinave. Ky plan i menaxhimit të mbeturinave korrespondon me ligjin për mbeturinat dhe Strategjinë Kombëtare për menaxhimin e mbeturinave si një plan afat mesëm.

Komuna e Vushtrrisë në kuadër të reformës në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe me qëllim të implementimit të Planit Lokal, si dhe Rregulloren për menaxhim të mbeturinave, përveç krijimit të mekanizmit institucional (emërimit të zyrtarit për menaxhim të mbetjeve dhe zyrës për inkasim) dhe mekanizmit financiar (planifikimin e taksës për mbeturina si e hyrë komunale), ka arritur që të bëjë:

- zbatimin e Planit të ri operativ që ka rezultuar me; vazhdimin e kontraktimit të shërbimit me Ndërmarrjen Regjionale „Uniteti” për tërë territorin e komunës, vazhdimin e mbledhjes së taksës për mbeturina si e hyrë komunale për vitin 2023, menaxhimi i softwerit pra sistemit të menaxhimit të të dhënave së bashku me listën e ekonomive familjare, profilizimin e klientëve, mënyrën e llogaritjes së kostos dhe nevojave financiare, shpërndarjen e faturës, mënyrën e pagesës, fushatën e vetëdijesimit publik, si dhe në ndërkohë verifikimin e fizibilitetit të projektit,
- zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohet në deponi përmes promovimit dhe praktikimit të ndarjes së mbeturinave që në burim, për zonën e përzgjedhur në qytet me 1500 ekonomi familjare, e cila sasi është duke u paketuar në Qendrën për paketim në Bukosh.
- projekti për ndarjen e mbetjeve në burim në të gjitha institucionet e arsimit dhe të shëndetësisë.

Gjithashtu është hartuar Raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2022 përmes platformës elektronike të instaluar nga AMM (Agjencioni për Mbrojtje të Mjedisit) dhe GIZ. Gjatë periudhës janar – shtator 2023 nga shkalla e gjenerimit të mbetjeve janë grumbulluar, transportuar dhe deponuar në deponinë në Gërmovë 15304.58 ton mbetje.

Tërë këto aktivitete kanë qenë të mbështetura nga konsulenca e vazhdueshme e GIZ-së përmes marrëveshjes së mirëkuptimit me ç'rast përfitimet e Komunës së Vushtrrisë kanë qenë shumë të mëdha. Përveç asistencës së vazhdueshme teknike përmes konsulentëve të angazhuar, është bërë hartimi i nismës për bashkëpunim ndërkomunal në mes të tri komunave të regjionit duke përfshirë Komunën e Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skenderajt, me çrast është hartuar Draft Plani Ndërkomunal dhe Draft - Marrëveshja për bashkëpunim ndërkomunal.

Kur jemi të mbulueshmëria me shërbim dhe projekti i grumbullimit të mbetjeve të diferencuara, GIZ ka financuar Garën për Mjedis të Pastër të lansuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përmes së cilës Komuna e Vushtrrisë nga vlerat përfituar prej 432,516.00 € është furnizuar me dy kompaktorë njëri 8 m³ dhe një kompaktorë 16m³, me një autofshisë në vlerën prej 73,516.00 € përderisa janë në dispozicion edhe 46,258.00 euro për blerjen e kontejnerëve për ndarje të mbeturinave në burim, blerja e të cilëve është në procedurë.

Ndërsa sa i përket deponive ilegale, komuna së bashku me Ndërmarrjen UNITETI në kuadër të aktivitetit për eliminimin e deponive ilegale, ka bërë eliminimin e disa deponive ilegale, me çrast aktualisht kemi vetëm 5 deponi ilegale të mëdha sepse pas shtrirjes së shërbimit në tërë territorin e komunës është bërë eliminim i qëndrueshëm i tyre.

Pra tërë këto aktivitete përbëjnë fushatën më të madhe mjedisore që për synim kanë pasur mbulueshmërinë me shërbim të tërë territorit të Komunës së Vushtrrisë, eliminimin e deponive ilegale, si dhe zvogëlimin e sasisë së mbetjeve që deponohen, përmes promovimit të ndarjes së tyre në burim dhe procesit të kompostimit.

Shtojcë e informatës:

- *Raporti vjetor i dërguar në AMM për vitin 2022*

Koment	Statusi i raportimit	Thirrja për raportim	Aktiv
Komuna Vushtri	Raportuar	31/03/2023	JO
		RAPORTIMI 2022	

 Ballina

(/Home/Index)

 RVMM1 - KOMUNAT 

(//)

Lista (/RVMM1/Index)



D:
ile

(/RVMM1_DEPONITE_ILLEGALE/Index)

? Dokumentimi (/Manuale/Ma...

RAPORT MBI PAJTUESHMËRINË ME KORNIZËN LIGJORE DHE PLANIFIKUESE PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

Pyetja	Po / Jo
1) A ka hartuar dhe miratuar me vendim, komuna juaj Planin Komunal për Menaxhim të Mbeturinave (PKMM) , bazuar në kërkesat në Ligjin për Mbeturina, i cili është ende valid ? Të deponohen në formë elektronike kopjet e skanuara të dokumenteve (dok 1: PKMM dhe dok2: vendimi i komunës për miratim të PKMM).	PO
2) A ka hartuar dhe miratuar komuna juaj Rregulloren Komunale për Menaxhim të Mbeturinave (RrKMM)? Të deponohet në formë elektronike kopja e skanuar e RrKMM qoftë në formë të nënshkruara apo me vendim të miratimit.	PO
3) A ka komuna juaj zyrtar për menaxhim të mbeturinave me punësim të përfshëm, përshkrimi i punës i të cilit siguron që të paktën 50% e përgjegjësitë janë në menaxhim të mbeturinave? Të deponohet në formë elektronike vendimi me përshkrim të punës të zyrtarit apo kontrata e punës apo (dok 1: vendimi i punës apo kontrata e punës).	PO
4) A ka komuna juaj inspektor mjedisor, përshkrimi i punës i të cilit siguron përgjegjësi në fushën e menaxhimit të mbeturinave? Të deponohet në formë elektronike vendimi me përshkrim të punës të zyrtarit apo kontrata e punës apo (dok 1: vendimi i punës apo kontrata e punës).	PO
5) A ka përzgjedhur dhe kontraktuar komuna operatorët e licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave komunale, duke zbatuar procedurat e prokurimit? Të deponohet në formë elektronike (dok 1: Kontrata apo marveshja me operatorin).	PO
6) A ka përzgjedhur dhe kontraktuar komuna operatorët e licencuar për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, duke zbatuar procedurat e prokurimit? Të deponohet në formë elektronike (dok 1: Kontrata me marveshje).	PO



Ballina

[\(/Home/Index\)](#)

RVMM1 - KOMUNAT

[\(//\)](#)[Lista \(RVMM1/Index \)](#)Dok
ile[\(/RVMM1_DEPONITE_ILLEGALE/Index\)](#)[? Dokumentimi \(Manuale/Ma...](#)

7) A ka caktuar komuna tarifat e shërbimit duke kaluar procesin tariforë për grumbullimin, transportin dhe depozimin e mbeturinave komunale, përmes kalkulimit të kostove të shërbimit, profilizimin e klientëve dhe caktimin e tarifave të shërbimit? Të deponohet në formë elektronike rregullorja komunale për menaxhim të mbeturinave (ku pjesë përbëse janë tarifat), si dhe tabelat që dëshmojnë procesin e kaluar në përcaktim të tarifës (dok 1: Rregullorja komunale për Menaxhim të mbeturinave dhe dok2: Procesi tarifor).

PO

8) A ka caktuar komuna, brenda territorit të vet, qendrën për grumbullim, trajtim dhe depozim të mbeturinave nga ndërtimi dhe demoliimi i objekteve ndërtimore? (dok 1: vendim për caktim të lokacionit).

PO

9) A ekziston struktura organizative e cila pasqyron inspektoratin, në komunën e juaj? Të deponohet në formë elektronike (dok 1: Organogrami)

PO

10) A ka raportuar komuna juaj për gjokat mandatore të shqiptuara gjatë vitit raportues? Të demonstrtohet me raportin e nënshkuar nga.....(dok 1:)

PO

RAPORT MBI IMPLEMENTIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

Nr.	Aktiviteti i synuar për vitin raportues	Objektivi përkatës i aktivitetit	Niveli aktual i realizimit	Koment
1	Kontraktimi i ofrimit të shërbimit per vitin 2022	Mbulueshmëria me shërbim	100%	Komuna dhe UNITETI
2	Filtrimi i listave të Klienteve	Rritja e shkallës së inkasimit	80%	Sistemi elektronik
3	Ofrimi i shërbimit cilesor dere me dore	Zvogelimi i shkallës së hedhjes ilegale	100%	Komuna dhe UNITETI

4 qytetareve, Klubeve te gjelberta

rendesine e procesit te ndarjes se

100%

përmes rakimeve dhe rjeteve sociale mbeturinave në burim



Ballina

(/Home/Index)



RVMM1 - KOMUNAT



(//)

Lista (RVMM1/Index)

D:
ile

(/RVMM1_DEPONITE_ILGALE/Index)

? Dokumentimi (Manuale/Ma...

Operatorët e licencuar për menaxhim të mbeturinave në komunë

Emri i plotë i operatorit	Adresa e operatorit	Numri i telefonit	Email adresa	Veprimtaria primare	Kodet e mbeturinave që trajtohen (KShM)	Numri i regjistrimit biznesit	N
KRM „UNITETI”- Njësia Punuese Vushtri	Rr. „Hamit Hyseni”, Vushtri	028 571 840	Kmmuniteti@hotmail.com			18110154719111	1.

Mbulimi me shërbim në territorin e komunës

Nr.	Emri i operatorit	Numri i ekonomive familjare që familjare	Numri i bizneseseve aktive në komunë	Numri i bizneseseve që pranojnë shërbimin e mbeturinave	Numri i institucioneve	Numri i bizneseseve që pranojnë shërbimin e mbeturinave
KRM „UNITETI”-						

1	Njësia Punuese Vushtri	11866	11866	884	884	164	164
---	------------------------	-------	-------	-----	-----	-----	-----

 Ballina

(/Home/Index)

 RVMM1 - KOMUNAT 

(//)

Lista (/RVMM1/Index)



D
ile

(/RVMM1_DEPONITE_ILLEGALE/Index)

? Dokumentimi (/Manuale/Ma...

Bilanci i mbeturinave

Nr.	Lloji i mbeturinave	Njësia matëse	Mënyra e përcaktimit të sasisë	Mbeturinat e dorëzuara	Mbeturinat e grumbulluara	Mbeturinat e grumbulluara prej konsumatorëve	Mbeturinat e grumbulluara prej operatorëve nga komunat tjera	Mbe grui prej per fizik ope brei kon
200301	Mbeturinat e përziera komunale	Ton	Majje	Jo	Po	19456.54	0	0

Faturimi dhe arkëtimi nga shërbimi i menaxhimit të mbeturinave

Nr.	Emri i operatorit	Quartali i parë	Quartali i dytë	Quartali i tretë	Quartali i katërt
1	200301 Mbeturinat e përziera komunale	346.00	458.00	342.00	326.00

 Ballina

(/Home/Index)

 RVMM1 - KOMUNAT 

(//)

Lista (/RVMM1/Index)

 De
ile

(/RVMM1_DEPONITE_ILLEGALE/Index)

? Dokumentimi (/Manuale/Ma...)

	PRMB -			
2	200101 Letër dhe karton	16.00	25.00	36.00 29.00
3	170202 Qelq	30.00	98.00	0.00 0.00
4	200108 Mbeturina të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat	162.00	223.00	172.00 112.00
5	200111 Tekstil	36.00	31.00	55.00 55.00
6	170203 Pllastikë	50.00	50.00	41.00 69.00
7	200140 Metal	5.00	8.00	3.00 2.00
8	200399 Fraksionet tjera pëmdrÿshe të paspecifikuara	47.00	23.00	35.00 59.00


Deponitë ilegale të regjistruara

Faturimi dhe arkëtimi nga shërbimi i menaxhimit të mbeturinave

Nr.	Emri i operatorit	Kategorië e klientëve të shërbyer	Faturimi - Vlera €	Numri i faturave të lëshuara	Arkëtimi - Vlera €	Numri i faturave të arkëtuara
-----	-------------------	-----------------------------------	--------------------	------------------------------	--------------------	-------------------------------

1	KRM „UNITETI“- Njësia Punuese Vushtri	Amvisëritë	775984.00	12	436304.00	12
---	---	------------	-----------	----	-----------	----

2	KRM „UNITETI“- Njësia Punuese Vushtri	Bizneset	226406.65	0	217631.64	0
---	---	----------	-----------	---	-----------	---

 Ballina

(/Home/Index)

 RVMM1 - KOMUNAT

(//)

Lista (/RVMM1/Index)

De
ile

(/RVMM1_DEPONITE_ILLEGALE/Index)

? Dokumentimi (/Manuale/Ma...

Asetet e komunës për menaxhim të mbeturinave dhe bilanci i tyre

Nr.	Kategoria	Lloji i asetit	Tipi	Kapaciteti	Viti i prodhimit	Targa	Vlera e librit - Bilanci Fillestarë (€)	Vlera e librit - Bilanci Përmbyljes (€)	Shpenzimet e zhvlerës (€)
1	Kontejnerë	Kontejnerë 120 l							
2	Kontejnerë	Kontejnerë 240 l							
3	Kontejnerë	Kontejnerë 1.1 m3							
4	Kontejnerë	Kontejnerë 7.1 m3							
5	Kamionët për grumbullim dhe transfer	Kamioni Nr. 1	Ivevo kompaktor	8	2001				02-690-AB
6	Kamionët për grumbullim dhe transfer	Kamioni Nr. 2	Iveco	8	2001				02-708-AB


 Ballina

(/Home/Index)

 RVMM1 - KOMUNAT 

(//)

Lista (/RVMM1/Index)

 Dë
ile

(/RVMM1_DEPONITE_ILLEGALE/Index)

? Dokumentimi (Manuale/Ma...

Kamionët
për
grumbullim
dhe
transfer

Kamioni
Nr. 3

Hyundai 5

2009

02-
502-
BH

Kamionët
për
grumbullim
dhe
transfer

Kamioni
Nr. 4

Mercedes 11

2008

02-
625-
EM

Kamionët
për
grumbullim
dhe
transfer

Kamioni
Nr. 5

Isuzi 4

2014

02-
330-
CL

Kamionët
për
grumbullim
dhe
transfer

Kamioni
Nr. 6

Scania 7

1988

02-
936-
CG

Kamionët
për
grumbullim
dhe
transfer

Kamioni
Nr. 7

iveco 7

2001

02-
680-
AB

Kamionët
për
grumbullim
dhe
transfer

Kamioni
Nr. 8

Mercedes 5

1981

02-
619-
CE

Kamionët
për
grumbullim
dhe
transfer

Kamioni
Nr. 9

Man 10

1986

02-
523-
BN

 Ballina

(/Home/Index)

 RVMM1 - KOMUNAT

(//)

Lista (/RVMM1/Index)



Dë
ile

(/RVMM1_DEPONITE_ILLEGALE/Index)

? Dokumentimi (/Manuale/Ma...

urre
transfer

Kamionët

për

14 grumbullim

dhe

transfer

Kamioni
Nr. 10

Iveco

8

2001

02-
520-
DQ

Kamionët

për

15 grumbullim

dhe

transfer

Kamioni
Nr. 11

Volvo

5

2008

02-
815-
EF

16 Kontejnerë

Kontejnerë
240 l

Qasja në ndajjen në burim

Kategoria	Prezentim hartografik (Ortofoto etj)	Emri i vendbanimit ku gjendet pika e grumbullimit dhe adresa	Koordinatat	Numri i ekonomive familjare që kanë qasje në infrastrukturën për ndajjen e mbeturinave në burim	Linku	Foto e lokacionit
Pikë grumbullimi të mbeturinave		zona ish varrezat e qytetit, zona Mustafa				

 Ballina

(/Home/Index)

 RVMM1 - KOMUNAT

(//)

Lista (/RVMM1/Index)

 Dë
ile

(/RVMM1_DEPONITE_ILLEGALE/Index)

? Dokumentimi (/Manuale/Ma...

që ofron
ndarje të
mbeturinave
të
riciklueshme

Venhari,
Iagja Bekim
Berisha
Abeja, Iagja
Bahri Kuqi

E | N:

4280

()

 (/RVMM1/F11DownloadDocs

Furnizim me
komposter I
familjeve

Bukosh

E | N:

150

()

 (/RVMM1/F11DownloadDocs

Sisteme të ndara për mbeturina të veçanta

Nr.	Lloji i mbeturinave	Qëllimi	Objektiva	Objektiva Masa / Aktiviteti	Alokimi i buxhetit
1	Mbeturinat nga Ndërtimi dhe Demolimi	zvoglimi i mbeturinave qe deponohet	zvoglimi i mbeturinave qe deponohet	Është paraparë	Është paraparë
2	Mbeturinat mjekësore	Është paraparë	Është paraparë	Është paraparë	Është paraparë

Efikasiteti i shpenzimeve

Kostot e stafit direct (€/vjet)

Nr. Staf direkt

Numri staff

Kostot e stafit direct (€/vjet)

 Ballina

(/Home/Index)

 RVMM1 - KOMUNAT

(//) Lista (/RVMM1/Index)



Dë
ile

(/RVMM1_DEPONITE_ILLEGALE/Index)

? Dokumentimi (Manuale/Ma...

1	Kryepunëtorë	3	14040.00
2	Shofer	17	74888.88
3	Punëtor	33	159327.51

Kosto e materialit direkt

Nr. Materiali direkt

Konsumi

1	Nafta	5437.67	8156.50
---	-------	---------	---------

Dokumentet e ngarkuara

Emri dokumentit Pyetja nga formulari F2

1.1. Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave (PKMM) dhe Vendimi i miratimit
[↓ \(https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2022/06/Plani-per-menaxhimi-e-mbeturinave-2022-2026.pdf\)](https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2022/06/Plani-per-menaxhimi-e-mbeturinave-2022-2026.pdf)





Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

09.nr. 94/23

DATE:	07.11.2023
PËR:	KPF-në dhe KK-në
NGA:	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural, z.Ergin Sunguri, drejtor 
PËMES:	z. Ferit Idrizi , Kryetar i Komunës 
TEMA:	<i>Informatë lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë</i>

Sektori për biznes

Qendra Komunale e Biznesit vepron në kuadër të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës - Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që është institucion i vetëm përgjegjës për regjistrimin e bizneseve të Kosovës. QKB –ja funksionon në bazë të një sistemi elektronik të dhënash, si një proces më i thjeshtë, më i shpejtë, pa shpenzime për regjistrimin e bizneseve fillestare, kërkesa për ndryshim si dhe shërbime të tjera. Sistemi i tanishëm ka ndikuar në rritjen e transparencës, si dhe ka një rritje të standardeve dhe përpjekjeve për të harmonizuar procedurat e regjistrimit me direktivat e Bashkimit Evropian

Qendra komunale e biznesit është e orientuar drejt zhvillimit, që ofron arritjen e efikasitetit më të madh, me një cilësi më të lartë për të gjitha bizneset që operojnë në komunën tonë.

Po ashtu është punuar në mënyrë sistematike dhe në shërbim maksimal për ofrimin e kushteve bizneseve për kryerjen e shërbimeve të tyre në mënyrë efikase dhe të shpejtë. Qëllimi ynë është të ofrojmë një shërbim institucional të përgjithshëm dhe të krijojmë kulturë administrative tek biznesi.

Me poshtë janë paraqitur të dhënat për numrin e bizneseve të reja regjistruara (biznese individuale dhe Sh.P. K) gjatë periudhës 01.01- 30.09.2023

Nr.	<u>Përshkrimi i aktivitetit</u>	<u>Nr.i llojit</u>	<u>Vërejtje</u>
1	Biznese të reja (të regjistruara) individuale	89	
2	Biznese të reja (të regjistruara) shoqëri me përgjegjësi të kufizua (SHPK)	171	
3	Kooperativa Bujqësore	2	
4	Biznese të shuara	33	
5	Ndërrime të logove të certifikatave	108	
6	Ndryshimet në bizneset ekzistuese	106	
7	Vërtetimet	10	

Gjithsej 517

QKB –ja përveç raporteve javore dhe mujore të cilat i dorëzon në Agjencinë për regjistrimin e bizneseve të Kosovës, dorëzon edhe në drejtorin për inspektime dhe sektorin e taksave të drejtorisë së financave me qëllim që të përcillen regjistrimet e reja të bizneseve dhe shuarjet e bizneseve ekzistuese.

Përveç shërbimeve të lartshënuara, Sektori i Bizneseve i DEBZHR ka kryer edhe lëndë të tjera si:

- vazhdimin e lejeve për transportin auto-taxi (gjithsejtë gjatë kësaj periudhe 38)
- dhënia e vërtetimit për personat të cilët nuk kanë biznes të regjistruar – (gjithsejtë për këtë periudhe 10)

Në vazhdim do të japim pasqyrën e bizneseve të regjistruara gjatë periudhës

01.01 – 30.09. 2023

A - Bujqësia Pylltaria dhe Peshkimi	12
C - Industria Përpunuese Prodhimtaria	32
D - Furnizimi me Rryme Gaz Avull dhe Klimatizim	7
E - Ujësjetësi Kanalizimi Menaxhimi i Mbeturinave dhe Aktivitetet e Riparimit	1
F - Ndërtimtaria	37
G - Tregtia me Shumice dhe Pakice Riparimi i Mjeteve Motorike dhe Motoçikletave	57
H - Transporti dhe Magazinimi	10
I - Hoteleria dhe Akomodimi	22
J - Informimi dhe Komunikimi	14
K - Aktivitetet Financiare dhe te Sigurimit	1
M - Aktivitetet Profesionale Shkencore dhe Teknike	17
N - Aktivitetet Shërbyese dhe te Përkrahjes	15
O - Administrimi Publik dhe I Mbrojtjes Sigurimi i Detyruar Social	2
P - Arsimi	3

Q - Aktivitetet e Shëndetit Njerëzor dhe te Punës Sociale	10
R - Artet Argëtimi dhe Rekreacioni	5
S - Aktivitetet Tjera Shërbyese	15
Total	260

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme nga 260 bizneset e regjistruara për periudhën 01.01. deri më 30.09.2023 edhe më tutje dominon veprimtaria tregtare 57 biznese nga 260 biznese sa janë të regjistruara, pastaj ndërtimtaria me 37 biznese sa janë të regjistruara, industria përpunuese me 32 biznese, bujqësia me 12 biznese etj.

- Ndërsa në bazë të dhënave të siguruar nga ATK – zyra regjionale në Mitrovicë, gjithsej numri i të punësuarave në komunën tonë – sektorin privat për vitin 2023 numri i të punësuarve dallon sipas muajve-mesatarja për vitin 2023 është 4458 të punësuar.

Objektivat e sektorit për zhvillim ekonomik – biznes janë:

- Ofrimi i shërbimeve të avancuara për biznese
- zvogëlimi i numrit të bizneseve pasive
- bashkëpunimi më i ngushtë me biznese e sidomos me ato prodhuese të cilat mund të krijojnë vende të reja të punës.
- vizitat me të shpeshta nëpër biznese me qëllim që të njihen me mundësit e zgjerimit të bizneseve të tyre
- Drejtoria për Ekonomi është e hapur çdo here për bashkëpunim me shoqatat e ndryshme afariste por edhe për çfarëdo kërkesë që vjen nga ato.
- themelimi dhe bashkëpunimi dhe më i ngushtë në mes të shoqatës afariste dhe Drejtorisë për Ekonomi.
- Përkrahja më e madhe e bizneseve bujqësore etj.

1	811916850	Xixa Xixellonja	Shaban Palluzha	D	SHPK	Mirvete Hyzeni	18.01.23	Vushtri	F
2	811109554	B.Individual	Smrekonicë	D	B.I.	Fatmir Rushiti	25.01.23	Vushtri	M
3	810127458	Exllent	Navalan	D	SHPK	Bajram Kovaci	30.01.23	Vushtri	M
4	811111848	B. Individual	2 Maji	D	B.I.	Faton Gërxhaliu	31.01.23	Vushtri	M
5	811301861	B. Individual	Sllatinë	D	B.I.	Bilall zeka	06.02.23	Vushtri	M
6	811113258	B. Individual	D. e Kombit	D	B.I.	Halit Zeneli	08.02.23	Vushtri	M
7	811564873	B. Individual	Stanoc I Poshtëm	D	B.I.	Benjamin Cakaj	13.02.23	Vushtri	M
8	811442722	B. individual	Bukosh	D	B.I.	Elmedina Beqiri	15.02.23	Bukosh	F
9	810108820	B.Individual	Vushtri	D	B.I.	Burbuge Parduzi	15.02.23	Vushtri	F
10	811107681	Old Hause Cecelia	Ceceli	D	SHPK	Besnik Merovci	28.02.23	Vushtri	M
11	810692592	B. Individual	Bedri Pejani	D	B.I.	Arsim Krasniqi	02.03.23	Vushtri	M
12	811955973	B. Individual	Akrashitçë	D	B.I.	Rahime Mehollli	06.03.23	Vushtri	F
13	811899882	Simit	Mic Sokoli	D	SHPK	Mensur Qerkezi	27.03.23	Vushtri	M
14	810683179	B.Individual	Vushtri	D	B.I.	Xhevdet Ahmeti	27.03.23	Vushtri	M
15	810107971	B.Individual	Sahit Avduilli	D	B.I.	Fehmi Hamiti	06.04.23	Vushtri	M
16	811975632	B.Individual	Skenderbeu	D	B.I.	Sabri Hyzeni	13.04.23	Vushtri	M
17	811308809	Quintech	Jakup Caraja	D	SHPK	Fitim Xhemajli	25.04.23	Vushtri	M
18	811388463	Gonix	Nedakofc	D	SHPK	Fatos Krasniqi	23.05.23	Vushtri	M
19	811115478	B.I	Pestovë	D	B.I.	Amir Ademi	21.06.23	Pestovë	M
20	810685480	B.I	Bedri Pejani	D	B.I.	Arben Krasniqi	06.07.23	Vushtri	M
21	811575200	B.I	Gj.K.Skenderbeu nr.225	D	B.I.	Ensar Kollari	06.07.23	Vushtri	M
22	810690596	B.I	Shote Galica	D	B.I.	Rama Haliti	12.07.23	Vushtri	M
23	811560318	B.I	Mexhid Cakajnr.21	D	B.I.	Blerta Mehani-Cakaj	13.07.23	Stanoc I eperm	M
24	811482463	B.I	Skenderbeu	D	B.I.	Valon Tërllabuqi	25.07.23	Vushtri	M
25	811420893	Computer Management	Skenderbeu nr.1	D	SHPK	Fidan Preteni	01.08.23	Vushtri	M
26	811111286	B.Individual	D.e Kombit	D	B.I.	Mentor Aliu	17.08.23	Vushtri	M
27	811558967	B.Individual	Bislim Kamer Imeri	D	B.I.	Labrik Halili	17.08.23	Vushtri	M
28	811315277	B.Individual	Vushtri	D	B.I.	Moris Hyzeni	17.08.23	Vushtri	M
29	811556911	B.Individual	Vushtri	D	B.I.	Genrit Jashari	30.08.23	Vushtri	
30	811951997	Jora Dekor	Islam Sallahu	D	SHPK	Fitim Hajrizi	31.08.23	Vushtri	M
31	811327883	B.Individual	2 Maji	D	B.I.	Skender Arbëri	25.09.23	Vushtri	M



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRISË

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

DATË /A:	20.11.2023
REFERENCË :	05Nr. <u>629</u> /23
PËR:	KK i Komunës së Vushtrrisë
CC:	Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave MPB, Komisionit Qendror për Vlerësimin e Dëmeve
PËRMES:	<i>Pert</i> z. Ferit Idrizi Kryetari i Komunës së Vushtrrisë
NGA:	z. Agim Miftari Sekretar dhe Kryesues i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera
TEMA:	Raport i vlerësimit të dëmeve nga FNFT

Në bazë të nenit 12.2, pika "d", të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 19, pika 1.4. si dhe nenet 4, pika 1,2,3 dhe neni 12, pika 1.5, bazuar në Rregullore (Qrk) Nr. 17/2015, për Metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera ka përgatitur raportin përmbledhës për dëmet e vlerësuara në territorin e komunës, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur më, _____ miraton këtë:

RAPORT I VLERËSIMIT TË DËMEVE NGA FATKEQËIT NATYRORE DHE FATKEQËSIT E TJERA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRISË SHTATOR-NËNTOR 2023

Dëmet në shtator 2023

Gjatë muajëve shtator, tetor dhe nëntor 2023 në komunën e Vushtrrisë, janë shkatuar dëme në ekonomi familjare dhe bujqësi, ku shkaktar ishin zjarret fushore, zjarri në shtëpi, qenët endacak dhe era e fortë.

Këto dëme po i pasqyrojmë në tabelat –shtojca 1:

Tabela 1: Lista e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara në muajin shtator 2023

Nr. Ren	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlerësimi i dëmit në euro(€)
1	Jakup Mehana	Akrashticë	Bujqësi	Zjarri fushor	700.00
	Jakup Mehana	Akrashticë	Ekonomi familjare	Zjarri fushor	660.00 €
2	Bislim Hashimi	Banjskë	Ekonomi familjare	Zjarri	9,041.00
Gjithsej					10,401.00

Tabela 2: Lista e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara në muajin tetor 2023

Nr. Ren	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlerësimi i dëmit në euro(€)
1	Skender Makiqi	Reznik	Bujqësi	Qentë endacak	1,250.00 €
2	Valon Pllana	Akrashticë	Bujqësi	Qentë endacak	780.00 €
3	Hysni Sadiku	Pasomë	Bujqësi	Zjarri fushorë	2,666.00 €
Gjithsej					4,696.00

Tabela 3: Lista e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara në muajin nëntor 2023

Nr. Ren	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Dëmi	Shkaku i dëmit	Vlerësimi i dëmit në euro(€)
1	Shaban Kosumi	Pestovë	Bujqësi	Era e fortë	1,520.00 €
2	Safet Morina	Pantinë	Bujqësi	Era e fortë	400.00 €
3	Sami Rexha	Pantinë	Ekonomi familjare	Era e fortë	40.00 €
4	Ergyn Dumnica	Vushtri	Ekonomi familjare	Era e fortë	1,010.00€
Gjithsej					2,970.00 €

Dëmet e shkaktuara nga FNFT në Komunën e Vushtrrisë, në muajt-shtator,tetor dhe nëntor 2023, kapin vlerën **18,067.00 €**

Komisioni:

1. Agim Miftari ,Ing. i Xehetarisë-sekretar - kryesues i komisionit
2. Avdyl Feka, Ing. i Bujqësisë-anëtar
3. Egzon Haradinaj, ing. i Arkitekturës
4. Betim Grabanica, Ekonomist- anëtar
5. Fadil Selimi, Gjeodet-anëtar

Agim Miftari

Avdyl Feka

Egzon Haradinaj

Betim Grabanica



Fadil Selimi



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Për: Kpf dhe Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës, z.Ferit Idrizi 
Hartues: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, znj. Fortuna Krasniqi Spahiu 
Tema: Propozim – vendim për Inicimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, pika “d”, nenit 17, paragrafi 1, shkronja (b), nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 5 paragrafi 1.2, pika 1.2.1, neni 6 paragrafi 1.2, dhe nenet 10,11,15 të Ligjitë Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinorë, Udhëzimit Administrativ Nr.11/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunalë si dhe , nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _____ 2023 mori këtë:

PROPOZIM- VENDIM
Për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032

Neni 1
Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim fillohet hartimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) për Komunën e Vushtrrisë.

Neni 2
Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i Planifikimit Hapësinor-Plani Zhvillimor Komunal në harmoni me ligjin si: “Plan Strategjik multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me Planin Zhvillimor Komunal, nga neni 1 i këtij Vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimit të tyre me nevojat reale dhe mundësit për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor të Komunës së Vushtrrisë, plotëson kërkesat ligjore për të përgatitur Planin Strategjik multi-sektorial, i cili përfshin planifikimin dhe zhvillimin e zonës urbane dhe rurale.

Neni 4 Kufiri i territorit

Zonat Kadastrale në territorin e komunës së Vushtrrisë të përfshira janë:

Nr.	Emri I z. kadastrale	kodi i zones	ha	ari	m ²
1	Balinc	70202002	282	41	52
2	Banjskë	70202003	358	63	37
3	Bequk	70202005	729	14	53
4	Bivolaku	70202006	301	44	92
5	Boshllani	70202007	423	2	33
6	Bruznik	70202009	329	81	53
7	Bukosh	70202010	582	71	59
8	Lumadh	70202011	192	76	41
9	Vesekofc	70202013	895	37	45
10	Vilanic	70202014	136	10	57
11	Vërnice	70202015	424	38	62
12	Vushtëri	70202016	1847	87	00
13	Gllavotin	70202017	262	15	21
14	Gojbulë	70202018	692	36	23
15	Dumnica e Epërme	70202019	696	96	79
16	Studime e Epërme	70202020	723	84	24
17	Stanofci i Epërme	70202021	809	73	33
18	Gracë	70202022	458	99	51
19	Gumnishtë	70202023	975	4	37
20	Dobërllukë	70202024	310	93	57
21	Dalaku	70202025	108	88	19
22	Dumnica e Poshtme	70202026	677	23	57
23	Studimja e Poshtme	70202027	440	96	3
24	Stanofci i Poshtëm	70202028	346	43	56
25	SYRACAK	70202029	447	19	59
26	Druar	70202030	819	20	55
27	Dubofci	70202032	987	60	52

28	Zhilivoda	70202033	470	30	63
29	Zagori	70202034	388	10	59
30	Liqeni-Jezera	70202035	416	30	73
31	Karaqë	70202036	304	9	1
32	Kolla	70202037	718	23	14
33	Kunovik	70202038	170	11	94
34	Kurillova	70202039	506	27	72
35	(Dumnica e Mesme	70202040	718	97	76
36	Mihaliq	70202041	117	132	0.65
37	Miraqë	70202042	271	76	88
38	Nedakoci	70202043	801	4.3	6
39	Novolani	70202044	727	83	19
40	Begaj	70202045	217	98	2
41	Maxhunaj	70202046	682	26	57
42	Akrashticë	70202047	415	56	61
43	Ashlan	70202048	449	10	44
44	Pantinë	70202049	484	38	31
45	Pasoma	70202050	633	86	21
46	Pestovë	70202051	426	36	69
47	Prelluzha	70202053	745	99	72
48	Rezniku	70202054	357	18	65
49	Popica	70202055	192	74	97
50	Samadrexha	70202056	1144	65	39
51	Skoqna	70202058	479	29	2
52	Skromë	70202059	692	70	78
53	Sllakofci	70202060	776	94	35
54	Sllatina	70202061	413	59	35
55	Gjytezë(Smrekonica)	70202062	424	37	73
56	Strofc	70202063	578	85	41
57	Taraxha	70202064	270	93	31
58	Tërllobuqi	70202065	373	32	35
59	Hercegovia	70202067	433	84	35
60	Cecelia	70202068	795	96	52
61	Shallci	70202069	724	17	34
62	Shlivovica	70202070	613	96	42
63	Shtitarica	70202071	179	77	5
64	Beqiqi	70215006	329	43	38
65	Galicë	70215013	443	35	38
		Gjithësej:	31429	22	39

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal caktohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ..

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit koordinon procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor të hartojë në afat prej 12 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8

Konsultimet publike

Projekti i Planit Zhvillimor Komunal para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe shqyrtim publik, paraqitja e Planit Zhvillimor Komunal në shqyrtim publik dhe koha për dhënia e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallet përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i Vlefshmërisë

Dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal hartohet për periudhën kohore 8 (tetë) vjeçare.

Neni 10

Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit (PZhK) sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhë zyrtare të Komunës dhe së paku 3 Kopje të shtypura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11

Programimi

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë në nenin 11 pika 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174.

Neni 12 Hyrja në fuqi

Me miratimin nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, ky vendim hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, dhe publikimi në web-faqen zyrtare të Komunës.


Melihate Basholli Latifi

Kryesuese e Kuvendit

A r s y e t i m

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit bazuar në PZhK 2016-2024 e cila ka vlefshmëri vetëm deri në vitin 2024 dhe për hartimin e këtij dokumenti i cili është Plan Strategjik multi-sektorial që përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor, kërkohet një periudhë afatgjatë për hartimin e këtij dokumenti, mirëpo në mungesë të kapaciteteve që zotëron ky organ, ne kemi parë të arsyeshme që tani të fillojmë me iniciimin për hartimin e këtij dokumenti të planifikimit pra PZhK, ku pas pasojnë edhe dokumentet tjera të planifikimit si : Harta Zonale e Komunës dhe Planet Rregulluese të Hollësishme.

Si dhe bazuar në rekomandimet e dhëna nga MMPHI që akti i komunës vendimi të plotësohet dhe ndryshohet me të dhënat e cekura në shkresën e MMPHI si dhe duhet të plotësohet me nenin 11 “Programi” dhe ti bashkëngjitet vendimit “ Programi për Hartimin dhe Menaxhimin e Procesit të Planifikimit” I paraparë në nenin 11 pika 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinorë Nr.04/L-174 Andaj bazuar në të lartcekurat ju propozojmë dhe procedojmë për aprovim kuvendit komunal të Vushtrrisë këtë vendim si në dispozitiv.

Drejtoreshë

Fortuna Krasniqi SPAHIU



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN	
01 Nr. / Br	239/23
Nr. i Eq. / Be. nr	-2-
Data: / Datum	26.10.2023
VUSHTRRI - VUČITRAN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, pika "d", nenit 17, paragrafi 1, shkronja (b), nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 5 paragrafi 1.2, pikat 1.2.1, neni 6 paragrafi 1.2, nenit 10,11,15 të Ligjit të Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinorë, Udhëzimit Administrativ Nr.11/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimorë Komunalë si dhe , nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **26 tetor 2023** merr këtë:

VENDIM

PËR INICIMIN E PROCEDURËS PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL 2024-2032

1. Me këtë vendim inicohet procedura e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) për Komunën e Vushtrrisë në afat të vlefshmërisë 2024-2032.
2. Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i Planifikimit Hapësinor-Plani Zhvillimor Komunal në harmoni me ligjin si: "Plan Strategjik multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor, Plani Zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare"
3. Me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, nga neni 1 i këtij Vendimi planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësit për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të Komunës së Vushtrrisë me qëllim të mbulimit të tërë territorit të Komunës së Vushtrrisë, duke përgatitur Planin Strategjik multi sektorial , i cili përfshin planifikimin dhe zhvillimin e Zonës Urbane dhe Rurale.
4. Ky plan mbulon tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë dhe bazuar në PZHK-në e aprovuar me vendim Nr. 126/17 të datës 04.05.201 Vushtrria ka territor prej 345 km², ose 34,500.00ha.
5. Bartës i hartimit të planit Zhvillimor Komunal caktohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë tjera të cilat funksionojnë brenda Komunës.
6. Mjetet për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë.

7. Projekti i PZHK-së para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe shqyrtim publik, paraqitja e PZHK-së në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallet përmes njoftimeve publike.

8. Dokumenti i planifikimit hapësinor hartohet për periudhën kohore 8 vjeçare.

9. Deri në Miratimit e Planit Zhvillimor Komunal vlejné dispozitat e Planit Zhvillimor Komunal, aktual me Nr. 126/17 të datës 04.05.2017, deri në miratimin e këtij akti të ri.

10. Dokumenti i planifikimit (PZHK) sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhë zyrtare të Komunës dhe së paku 3 Kopje të shtypura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

11. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit